

“Jo secili prej nesh mund të bëjnë gjëra të mëdha, por të gjithë mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe” Nënë Tereza



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 129, korrik 2014
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

DUKAGJINI DUHET DHE DO TË RROJË

Ndodhi ajo që po flitej prej kohësh. Ligjërish dukagjini i vunë vizën, e fshinë si nocion zyrtar, si emër, nga harta e Shqipërisë. E fshinë nga harta atë pjesë të shqiptarizmit, të atdhetarisë, të pamposhtur, të papërkulur në shekuj, u fshi nga harta ai emër i madh i asaj pjese të Shqipërisë që pranoj të jetojë midis malesh, i izoluar nga bota, me vështirësi të panumërta natyrore dhe shoqërore, sepse deshi lirinë, sepse deshi vendin, sepse deshi besimin, kulturën, traditën, historinë, sepse deshi të rriste pasardhës të lirë dhe me traditat më të mira të kohës e këto tradita tua transmetonte pasardhësve të vet. Jetoj malësori dukagjinasi me shpresën se një ditë do të shikonte krahinën e tij, vendin e tij, të zhvilluar, të përparuar dhe të ecte përkrah popujve të tjerë. Shumë përpjekje u bënë gjatë historisë së këtij populli për ndarje e bashkime nga më të ndryshmet, por gjithnjë munda të ruaj identitetin dhe të formuar gjatë shekujve. Nga Luigj Shyti



Refleksione

- nisur nga libri
**“DHUNA”, me autor
Lekë Imeraj -**

Kam marre pjese në gjithë promovimet e botimeve, tashme të shkrimtarit dhe përkthyesit Leke Imeraj. Secili më integrues se tjetri! Secili më afër realitetit të kohës, që në përgjithësi më mire duhet t'i njohim! Secili më i dashur për lexuesin dhe secili që i ka lexuar jo në pak raste, ka gjetë ten në to dhe i ka bere pyetjen Kush jam? Ku bej pjese?



Banorët e Dukagjinit duan të qëndrojnë njësi administrative në vete

Hartën finale të ndarjes territoriale të Shqipërisë nuk e kundër shtojnë vetëm fshatrat, komunat dhe bashkitë e dominuara nga minoriteti grek. Edhe Dukagjini i Shkodrës shprehet kundër ndarjes së re territoriale. Banorët e pesë komunave të Dukagjinit të Shkodrës u janë drejtuar me një petition krerëve të shtetit shqiptar, ku kërkojnë që Dukagjini të mos bashkohet me Shkodrën. Banorët e kësaj zone etnografike kërkojnë që Dukagjini të mbetet njësi më vete vendore. Peticioni u drejtohet Presidentit Bujar Nishani, kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta, kryeministrit Edi Rama, ministrit të Pushtetit Vendor, Blendi Çuçi, Bashkim Finos, kryetarit të Partisë Demokratike, Lulëzim Basha, Prefektit të Qarkut Shkodër, z. Paulin Radovani, kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, Metëld Cungu, si dhe per dijeni: Avokatit te Popullit, z. Igli Totozani dhe Arqipeshkvit të Metropolit të Dioqezës Shkodër, Imzot Angelo Massafro.

Si ndjehet Rrogami mes Valbonës dhe Thethit?

Nga Zef Bari

NDAHET NGA JETA DILA NDOJA ANËTARE NDERI E SHOQATËS “ATDHETARE DUKAGJINI”



4 Korriku, 238 vjetori i Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës

4 KORRIK 2014, U MBUSHËN 238 VJET NGA DITA, QË KUR BURRAT MË TË NDRITUR TË KOMBIT AMERIKAN, NËNSHKRUAN DEKLARATËN E PAVARËSISË, DUKE U BETUAR, ASHTU SIÇ THUHET EDHE NË DEKLARATË, PËR NDERIN E TYRE, TË KOMBIT TË CILIT ATA I PËRKISIN

Burrnesha e Dukagjinit ZOJË MUSTAFJA

Shumë shkrime, këngë, vjersha dhe studime janë bërë për Dukagjinin. Por asnjëherë nuk ju vjen fundi shkrimeve, ...



VASFI DUKA

NË PËRKUJTIM TË INXHINIERIT TË TALENTUAR, ZBULUESIN E MINERALEVE TË NGURTA, BIRIN E VRANISHTIT TË PËRMENDUR TË VLORËS, ANËTARIN E NDERIT TË SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI”



Mundësoi Botimin:
GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh Kimay
PRODUCTION Produzione Glacche



DUKAGJINI DUHET DHE DO TË RROJË



Ndodhi ajo që po flitej prej kohësh. Ligjërisht Dukagjini i vunë vizën, e fshinë si nocion zyrtar, si emër, nga harta e Shqipërisë. E fshinë nga harta atë pjesë të shqiptarizms, të atdhetarisë, të pamposhtur, të papërkulur në shekuj, u fshi nga harta ai emër i madh i asaj pjese të Shqipërisë që pranoj të jetojë midis malesh, i izoluar nga bota, me vështirësi të panumërta natyrore dhe shoqërore, sepse deshi lirinë, sepse deshi vendin, sepse deshi besimin, kulturën, traditën, historinë, sepse deshi të rriste pasardhës të lirë dhe me traditat më të mira të kohës e këto tradita tua transmetonte pasardhësve të vet. Jetoj malësori dukagjinas me shpresën se një ditë do të shikonte krahinën e tij, vendin e tij, të zhvilluar, të përparuar dhe të ecte përkrah popujve të tjerë. Shumë përpjekje u bënë gjatë historisë së këtij populli për ndarje e bashkime nga më të ndryshmet, por gjithnjë mundi të ruaj identitetin e tij të formuar gjatë shekujve.

Është e natyrshme dhe në dobi të zhvillimit që të bëhej ky riformatim i territoreve të Shqipërisë, sepse koha e kërkon, do të kenë më shumë zhvillim. Kjo reformë mund të sjellë më shumë përparim në të gjithë territorin, por që të arrihet një gjë e tillë duhet mendim përparimtar në mënyrë që të mos shikohet dikush më syrin e nënës dhe dikush më syrin e njerëzës. Në kushtet që kemi parë deri tash, është vështirë që të kemi bindjen se do të ndodhë shikimi më të njëjtin sy të gjitha zonat.

Dukagjini është konfiguar në histori dhe kulturë, në etnografi dhe marrëdhëniet shoqërore, është i

spikatur në identitetin kombëtar, është një komunitet kompakt i maleve shqiptare që nuk mund të tjetërsohet. Për këtë ka dhënë prova. Ajo që nuk u arrit të bëhej në të kaluarën që nga thellësia e historisë, u bë sot në vitet e demokracisë. Kjo nuk është normale. Dukagjini ka hyrë në histori si krahinë kryengritëse kundër osmanëve, kundër serbëve dhe malazeze, kundër regjimit zogist, kundër regjimit komuniste dhe është një krahinë pararojë për demokratizimin e vendit. Kjo krahinë duhet të meritonte një vëmendje shumë më të madhe nga shteti dhe Qeveria Shqiptare.

Dukagjini me banorët e tij e kanë dashur dhe e duan reformën territoriale dhe kanë besim në tërësi te ajo, por bashkime nga më të paparaturat, nuk mund të paparashikuarat, nuk mund të japin rezultatin e dëshiruar. Dukagjini asnjëherë nuk e ka refuzuar bashkimin me Shkodrën, nuk është thënë në asnjë vend dhe në asnjë shkrim. Shoqata "Atdhetare Dukagjini", intelektual dukagjinas, pjesëtarë të komunitetit të kësaj zonë, nëpërmes diskutimeve, balafaqimeve, komunikimeve të drejtpërdrejta nga baza deri në qendër, peticioneve, kanë kërkuar që krahina e Dukagjinit të jenë një njësi administrative e veçantë, e cila do të shërbente më mirë komunitetit të kësaj krahinë, do të ndiqte nga afër dhe do të zhvillonte këto zona me shumë resurse shoqërore, historike dhe natyrore.

Dukagjini nuk kishte sesi të fshihet nga harta e Shqipërisë më një të rënë të lapsit. Nuk zhduket dhe nuk do të zhduket kaq lehtë emri i një krahine ku jeton një komunitet që ka mbijetuar në shekuj midis vështirësive të jashtëzakonshme.

Duke e ndjerë thellë në shpirt, këtë që u vendos në ditën e fundit të muajit korrik, si një padrejtësi të madhe ndaj këtij komuniteti rikujtoj se janë bërë propozime konkrete që në fillim të këtij viti, sidomos nga Shoqata "Atdhetare Dukagjini", por edhe nga persona të veçantë,

janë bërë shkrime në gazeta lokale dhe qendrore, u është drejtuar letër-kërkesë të gjithë organeve shtetërore qendrore dhe Kryetarit të Opozitës në lidhje me Dukagjinin, por asnjëri prej tyre nuk e ka marrë mundimin as që të takojë pjesëtarë të komunitetit, por as që të marrin mundimin për të kthyer një përgjigje ashtu siç e mendonin ata.

Ndarja e fundit administrative, porsa i përket dukagjinit, është shumë e pastudiuar sepse:

- Nuk është menduar për Dukagjinin si emër shumë i vjetër, si familje princërore, si dinasti dhe as si territor gjeografik.

- Nuk është menduar për zhvillimin e Alpeve Shqiptare.

- Nuk është menduar për mos shpopullimin e këtyre territoreve.

- Nuk është menduar për zhvillimin e turizmit shumë të kërkuar dhe me shumë mundësi në këtë zonë.

- Nuk është menduar për ruajtjen e vlerave të pakrahueshme historike, kulturore, etnografike të kësaj krahinë.

- Nuk është menduar për gjurmët e historisë që po "vdes" në këto male e lugina dhe që flasin për rrënjët e thella që ka ky komunitet në këtë zonë.

- Nuk është menduar për kulturën materiale dhe shpirtërore të kësaj krahinë dhe këtyre banorëve, të cilat duke u shpërndarë nga Maja e Jezercës e deri në breg të detit ka shumë vështirësi që të rruhet, e aq më pak të kultivohet e transmetohet.

Ka mendime se është vepruar keq më parë nga sistemi i kaluar në lidhje me Dukagjinin edhe në pikëpamjen administrative, veçanërisht në fillim të viteve '70. Po pa tjetër që është evidente një gjë e tillë, për të cilën edhe është folur edhe këto kohë e fundit, por nuk duhet menduar se një e keqe mund të rregullohet me një të keqe tjetër. Dy të këqija kur nuk bëjnë një të mirë por mbeten gjithnjë dy të këqija.

Është interesante se që kur filloi të diskutohej kjo refor-

më nuk u bënë të gjallë ata që nuk lanë derë pa trokitur për të mbledhur vota për vetë dhe për shokët e vet, nuk lanë telefon që të pushojë natën as ditën nuk kohë fushate për zgjedhjet, nuk lanë premtim pa bërë individualisht dhe publikisht. Pati nga ta që morën përsipër përfaqësimin e Dukagjinit në mënyrën më të mirë, në kohën që djemtë dukagjinas i renditën në vendin e 11 apo 12 nga 11 deputet të mundshëm që do të kishte Qarku i Shkodrës.

Kjo reformë nuk është politike, gjë që u pa jo një herë edhe në lidhje me komunitetin dukagjinas. Ajo është administrative, këtu nuk ka vend politika, por gjithsesi pesha kryesore bie mbi ata që qeverisin vendin dhe kanë shumicën e cilësuar në parlament.

Komuniteti dukagjinas është dhe duhet të jetë gjithnjë me ata që mendojnë, përpiqen, mbështesin dhe punojnë për këtë komunitet, me qëllim që të integrohet në jetën politike, sociale dhe ekonomike.

Nuk mungoi angazhimi edhe në këtë rast, gjë të cilën e përmendëm më lart, por ra në vesh të shurdhër. Kjo punë nuk u la për ditën e fundit veçanërisht nga Shoqatat "Atdhetare Dukagjini". Morëm pjesë aktive në diskutimet që u organizuan në shkallë qarku. U bënë shkrime e letra, u bënë prononcime në median elektronike lokale dhe qendrore nga intelektual dukagjinas, u bënë peticione e takime, morëm pjesë në mitingje duke bllokuar edhe rrugën Shkodër-Tiranë, por nga atje lartë asnjë reagim. Duhet thënë se mungoi lidhja midis Komunave të Dukagjinit, edhe një takim i kryetarëve të Komunave që u bë ishte shumë i vonuar, nuk pati reagim masiv brenda ligjeve demokratike. U përdor rrjeti social për të nxitur mendimin dhe kërkesën ku morën pjesë shumë persona, por pjesëmarrja në tubime për të paraqitur kërkesa ishte jo e mundshme për të bërë që të dëgjohet zëri ynë. Nuk ndryshohen projektet apo ligjet

me disa veta qoftë edhe me bllokimin e rrugëve automobilistike. Madje, duke mos pasur besim në vetvete, apo duke mos pasur bindjen në mbështetjen e komunitetit, pati raste që u "thirrën" për mbështetje edhe strukturat e vjetra fisnore, gjë që nuk është normale për kohët moderne. Ne i respektojmë sinqerisht këto organizime për vendin që u ka dhënë historia.

Në ditën e fundit pati zëra që e përmenden Dukagjinin, por jo se u dhimbej ai, por për të kërkuar dhe gjetur mbështetje e justifikuar fjalët e tyre. Ku ishin deri tash këta "dashamirës" të Dukagjinit dhe dukagjinasve, që "qanin" për Dukagjinin në kohë fushatash, që vetëm sot nxorën nga gurmazi i tyre pjesë fjalësh apo fjalishë për këtë zonë që meritonte dhe meriton më shumë. Ishte vonë, tepër vonë, ishte si të vendosësh nga arnë të zi me pe të bardhë. Nuk është alternativë vetëm të jesh kundër diçkaje, qoftë kjo edhe reforma territoriale, por as të bësh të diturin në ditët e fundit kur ka marrë formë gjithçka. Trimëria pas lufte dhe urtia pas kuvendit nuk vlejnë – thotë populli.

Dukagjini, ky emër i madh në histori, i shfaqur në vitin 695, pra rreth 13 shekuj më parë, pas Krishtit, duhet të rrojë sepse është përfaqësues i thellë në histori, i njohur në të gjitha kontinentet, i dashuruar dhe i bërë pjesë e jetës dhe trupit të banorëve që e ruajtën dhe e trashëguan në shekuj, duhet të rrojë sepse brenda këtij emri gjëmon historia, kultura, besimi dhe organizimi shembullor për kohën.

Besojmë se banorët dukagjinas, me vitalitetin që i karakterizon, do të ruajnë traditat e mira të këtij emri, në ndërgjegjen e tyre, në fjalën e tyre, në sjelljen e tyre. Unë besoj se secili pjesëtar i këtij komuniteti do të jenë krenar që është Dukagjinas, dhe këtë do tua transmetojnë brezave të ardhshëm.

Pas kësaj që ndodhi, vetëm kështu mund dhe duhet të ruhet emri

Banorët e Dukagjinit duan të qën- drojne njësi administrative në vete

Hartën finale të ndarjes territoriale të Shqipërisë nuk e kundër shtojnë vetëm fshatrat, komunitet grek. Edhe Dukagjini i Shkodrës shpreh kundër ndarjes së re territoriale. Banorët e pesë komunave të Dukagjinit të Shkodrës u janë drejtuar me një peticion krerëve të shtetit shqiptar, ku kërkojnë që Dukagjini të mos bashkohet me Shkodrën. Banorët e kësaj zone etnografike kërkojnë që Dukagjini të mbetet njësi më vete vendore. Peticioni u drejtohet Presidentit Bujar Nishani, kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta, kryeministrit Edi Rama, ministrit të Pushtetit Vendor, Blendi Çuçi, Bashkim Finos, kryetarit të Partisë Demokratike, Lulëzim Basha, Prefektit të Qarkut Shkodër, z. Paulin Radovani, kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, Maxhid Cungu, si dhe per dijeni: Avokatit te Popullit, z. Igli Tozani dhe Arqipeshkvit të Metropolit të Dioqezës Shkodër-Pult, Imzot Angelo Massafro.

ARGUMENTET

Banorët e pesë komunave të Dukagjinit nënvizojnë disa argumente se pse kjo zonë duhet të jetë njësi administrative më vete. “Dukagjini e meriton të jetë një zonë administrativo-territoriale më vete, nisur nga fakti se ka një territor me sipërfaqe 609,2 km2 me reliev të thyer, përfshin alpet qendrore është zonë kufitare, ka resurse të shumta për të përballuar nevojat si njësi më vete. Me përparësi janë: blegtoria, turizmi, energjetika, shfrytëzimi pyjor, bimët medicinale, frutikultura e në veçanti gështenja etj. Kjo zonë nuk mund të humbasë etnografinë, historiografinë, traditën, emrin dhe kulturën e trashëguar ndër shekuj. Nga studimet arkeologjike rezulton se Dukagjini ka 4(katër) qyteza dhe 3(tre) kështjella të lashta. Dukagjini në historikun e tij në shekuj, rezulton administrim më vete, me cilësi zonë autonome, nënprefekturë, rreth, legalitet, e sot nuk mund të fshihet nga harta e Republikës së Shqipërisë”, thuhet në peticion. Në peticion thuhet se Dukagjini si çdo popull tjetër ka të drejtë dhe e meriton të qeverisë dhe të administrojë vetveten, kjo e mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. “Dukagjini nuk mund dhe s’duhet të fshihet nga harta gjeopolitike - administrative e Republikës së Shqipërisë, kjo konfirmohet përmes përfaqësuesve legjitim të popull-

lit të Dukagjinit. Shpresojmë dhe besojmë se Qeveria Shqiptare do të respektojë njësinë administrative-territoriale të Dukagjinit si njësi më vete. Me firmosje të këtij peticioni Populli i Dukagjinit shpreh vullnetin e tij”, thuhet në peticion.

HUMBJA E STATUSIT LOKALITET

Në vitin 1948 në mënyrë djallëzore kësaj krahine i merren Nikaj-Mërturi për të krijuar rrethin e Tropojës, ndërsa Shllaku i bashkëngjitet rrethinave te Shkodrës dhe Dukagjini humbi statusin e rrethit që kishte si krahinat si motra Puka, Malësia e Madhe dhe Mirdita duke kaluar në Lokalitet në përbërje të Shkodrës. Më Projektin përfundimtarë të ndarjes e re administrative paraqitur nga shumica Komunitet Shllak dhe Temal i kalojnë Nënshkodrës, kurse komunitet Shalë, Shosh dhe Pult i bashkëngjiten Bashkisë së Shkodrës me shtrirje nga Jezerca në Adriatik. Kjo ndarje fshinë përfundimisht nga harta politike administrative e Shqipërisë një krahinë që ka identitetin e vet kulturor, regional dhe pozitën gjeografike të virgjër alpine.

FIGURAT E DUKAGJINIT

Dukagjini i Martin Camajit, Ernest Koliqit, Benardin Palajt, Ndoc Nikajt, Lin Delisë, Ferdrik Reshpes, Pjeter Gjokës, Ndrejë Lucës, Tinka Kurtit, Zef Shoshit, Lec Shllakut, Zef Malës, Prof Kolë Prelës, Feredrik Ndocit; Kampionve të paharruar Pal Mirashi, Lin Shllaku, Simon Deda, Dodë Tahiri, Prekë Gjeloši, Agustin Kola, Armir Grima, Mirash Vuksani, Ndue Njemza, Vera Bregu, Dedë Bregu etj ka çfarë të tregoj se i ka edhe elitës kulturore e sportive shqiptare. Dukagjini homerik i lekëve i larmë gjak dhe mbijetuar përmes sakrificash martire shekullore, i persekutuar dhe lënë jashtë vëmendje nga gjitha qeveritë shqiptare nuk mund të fshihet me lapës nga harta administrative e Shqipërisë, duke bërë atë që nuk kanë guxuar të bëjnë as turqit ndonëse e kishin murriz në zemër.

DUKAGJINI

Dukagjini shtrihet në Veri të Shkodrës dhe zë pjesën qendrore dhe lindore të masivit madhështor të Alpeve shqiptare me sipërfaqe 609,2 km katrorë dhe popullsi mbi 12 mijë banorë edhe pas rrjedhjeve të mëdha pas viteve nëntëdhjetë. Aktualisht përbehet nga 5 komuna Shala, Shoshi, Pulti, Shllaku,

Temali. E konfiguruar historikisht si treve historike dhe etnografike me identitet të spikatur kombëtarë, Dukagjini është blloku i vetëm kompakt i maleve shqiptare së bashku me Mirditën që ruajti homogjenitetin kristian duke u vetëqeverisur sipas së Drejtës së tij Zakonore në kohën e gjatë të sundimit otoman. Dukagjini ka hyrë në histori si zonë e kryengritësve dhe qendrestarëve ndaj turkut, serbeve, malazezve, anti-Zogiste, anti-komuniste dhe treva pararojë e në lëvizjen demokratike të vitit 1990.

PETICIONI I PLOTË I BANORËVE TË DUKAGJINIT DREJTUAR KRERËVE TË SHTETIT

Ne mendojmë se reforma administrativo-territoriale është një poqes i rëndësishëm dhe i domosdoshëm, por jo pak i ndërlikuar që duhet trajtuar me përkushtim dhe nacionalitet. Referuar gjendjes aktuale të ndarjes administrative-territoriale të qeverisjes vendore, vihet re një copëzim i tepruar i territorit shqiptar i padobishëm, fakt i cili ndikohet nga shumë faktorë, por në fokus kemi ndarjen administrative-territoriale. Mendojmë se parimet e reformës territoriale nuk po zhvillohen me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të të gjitha palëve dhe grupeve të interesit, lë për të dëshiruar informimi dhe konsultimi me komunitetin. Afati kohor për zhvillimin e reformës së ndarjes administrativo-territoriale është i përshpejtuar. Harta e re territoriale e paraqitur me 5 (pesë) variante për ndarjen administrative - territoriale përmes ministrit të pushtetit vendor, Z. Blendi Çuçi, përpara komisionit të posaçëm parlamentar, çon në: a. grupe të stërmëdha që mund të ndikojnë në qeverisje jo realizuese të pushtetit vendor, duke ulur aksesin, efikasitetin dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimeve publike vendore; b. grupe të stërmëdha ndikojnë në dëmtimin e mekanizmave të demokracisë përfaqësuese dhe dobësimin e instrumenteve të demokracisë direkte; Politikat afatgjata të zhvillimit të infrastrukturës në zonat rurale ndikojnë pozitivisht në popullimin e tyre dhe në ruajtjen e raporteve të shpërndarjes demografike. Populli i Dukagjinit kërkon që të përfshihet në hartën e re të reformës administrativo-territoriale, si njësi administrative në vete, pasi i plotëson kriteret e veçanta si:

1. Popullsia plotëson nivelin e tretë për numrin minimal të popullsisë që duhet të ketë një njësi e qeverisjes vendore, mbi 10 000 (dhjetë mijë) banorë, duke marrë parasysh dendësinë për km2, kjo e mbështetur në karakteristikat gjeografike të zonës. Lëvizja demografike e popullsisë nga kjo zonë, ka ardhur si pasojë e mungesës së infrastrukturës. Infrastruktura e zhvilluar mund të ndikojë në ripopullimin e mëtejshëm të zonës.

2. Dukagjini e meriton të jetë një zonë administrativo-territoriale në vete, nisur nga fakti se ka një territor me sipërfaqe 609,2 km2 me reliev të thyer, përfshin alpet qendrore është zonë kufitare, ka resurse të shumta për të përballuar nevojat si njësi në vete. Me përparësi janë: blegtoria, turizmi, energjetika, shfrytëzimi pyjor, bimët medicinale, frutikultura e në veçanti gështenja etj.

3. Kjo zonë nuk mund të humb etnografinë, historiografinë, traditën, emrin dhe kulturën e trashëguar ndër shekuj. Nga studimet arkeologjike rezulton se Dukagjini ka 4(katër) qyteza dhe 3(tre) kështjella të lashta. Dukagjini në historikun e tij në shekuj, rezulton administrim më vete, me cilësi zonë Autonome, Nënprefekturë, Rreth, Legalitet, e sot nuk mund të fshihet nga harta e Republikës së Shqipërisë.

4. Distanca e territorit jashtë qendrës së kësaj zone nuk mundëson ofrimin e gamës së plotë të shërbimeve për banorët e saj, e cila duhet vendosur në qendër të njësisë së re të krijuar.

5. Dukagjini e meriton që të përfshihet në hartën e re të reformës administrativo-territoriale, si një njësi administrative në vete, pasi respekton parimin e vazhdimësisë territoriale, ka një traditë historike dhe karakterizohet nga lidhje tradicionale mes banorëve të gjithë territoreve përbërëse. Kjo zonë ka shumë bijë dhe bija në emigracion të cilët mund të investojnë për zhvillimin e Dukagjinit. Dukagjini si çdo popull tjetër ka të drejtë dhe e meriton të qeverisë dhe të administrojë vetveten, kjo e mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dukagjini nuk mund dhe s’duhet të fshihet nga harta gjeopolitike - administrative e Republikës së Shqipërisë, kjo konfirmohet përmes përfaqësuesve legjitim të popullit të Dukagjinit. Shpresojmë dhe besojmë se Qeveria Shqiptare do të respektojë njësinë administrative-territoriale të Dukagjinit si njësi në vete. Me firmosje të këtij peticioni Populli i Dukagjinit shpreh vullnetin e tij.

*Marre nga gazeta “SOT”,
date 22 korrik 2014*

Dukagjin dhe dukagjinat. Intelektualët dukagjinat, ashtu si edhe deritash, duhet të ngulmojnë në vlerat e territorit, të banorëve dhe gjithë trashëgimisë shumë të madhe të pashtershme dhe të pa përsëritshme të kësaj zone. Të gjithë duhet të ndjehemi krenar që jemi dukagjinat, dhe kemi këtë emër që na bën nder gjithmonë.

Flamurtare pararojë e njohjes, ruajtjes dhe transmetimit të këtyre vlerave, prej 11 vjetësh dhe në vazhdim është dhe do të jetë Shoqata “Atdhetare Dukagjini”. Ajo me programin e saj, me vizionin e saj, me veprimtarët e saj gjithnjë aktiv dhe veprimtarët pranë saj, ka bërë të mundur njohjen, vlerësimin dhe propagandimin e vlerave njerëzore, historike dhe natyrore të Dukagjinit.

Shoqata “Atdhetare Dukagjini” ka punuar me këmbëngulje gati heroike

për Dukagjinin. Mund të thuhet pa ndrojtje se ajo ka bërë më të mirën e mundshme, atë që nuk e ka bërë askush për njohjen dhe popullaritetin e vlerave më të mira të Dukagjinit.

Sot më shumë se asnjëherë më parë duhet punuar rreth vlerave të kësaj krahine që shpata e politikës e goditi në mënyrë të pamëshirshme. Historikisht ka ndodhur që në raste ndarjesh dhe bashkimesh, komuniteti ka shtrënguar lidhëzat, ka afruar pikat e bashkimit, për të mos u tretur si kripa në ujë, për të mos humbur pa shenjë. Është domosdoshmëri njohja e këtyre lidhëzave, pikave të bashkimit. Nga pikat më të forta, më të mundshme për tu bashkuar, aktualisht është Shoqata “Atdhetare Dukagjini”. Pranë kësaj shoqate, punës dhe gazetës së saj do të jenë një vend bashkimi, një pikë referimi, pa dallim bindjesh politike. E përsëritim

me forcë se partia më e madhe, më e mirë, me e dashur, për Shoqatën “Atdhetare Dukagjini”, për kryesinë dhe anëtarët saj, është Dukagjini. Kjo nuk ka asnjë mëdyshje për ne. Kjo mendojmë se duhet të jenë edhe për të gjitha ata që e mendojnë veten dukagjinat, e duan dhe do të duan Dukagjinin më gjithë kulturën e mirë të tij. Komuniteti dukagjinat, Shoqata “Atdhetare Dukagjini” me të gjitha forcat dhe mundësitë, ka punuar dhe do të punojnë për integrimin në gjithë jetën e vendit, prandaj duhet të jemi sa më ta bashkuar, të jemi shumë gjithëpërfshirës, të largojmë sa më shumë përemrin “unë” që është shumë i rrezikshëm, dhe të pranojmë gjithnjë e më shumë përemrin “ne”, të punojmë më shumë me njëri tjetrin dhe për njëri tjetrin, ta dëgjojmë njëri tjetrin dhe të pranojmë mendimin

ndryshe e ti largohemi imponimit me çdo kusht dhe me të gjitha mënyrat. Në qoftë se duam të zhvillohemi, të përparojmë, të integrohemi në kohën që jetojmë dhe të përgatitemi për të ardhmen, të ruajmë etninë, historinë dhe kulturën materiale dhe shpirtërore duhet punuar fort. Këto për Shoqatën “Atdhetare Dukagjini” kanë qenë dhe janë në plan të parë, janë prioritetet e prioritetëve. Në qoftë se, në rrethanat e reja që u krijuan, nuk mblidhemi, koha do na ndëshkojë rëndë, brezat e ardhshëm do na dënojnë dhe edhe për së vdekuri do tu jemi borxh. Të bëjmë detyrën ne sot, që brezat e ardhshëm të jenë kryelartë për të kaluarën e tyre.

Luigi SHYTI
*Sekretar i Shoqatës
“Atdhetare Dukagjini”
Shkodër, 01.8.2014*

Refleksione

- nisur nga libri “DHUNA”, me autor Lekë Imeraj -

Kam marre pjese në gjithë promovimet e botimeve, tashme të shkrintarit dhe përkthyesit Leke Imeraj. Secili më integrues se tjetri! Secili më afër realitetit të kohës, që në përgjithësi më mire duhet t’i njohim! Secili më i dashur për lexuesin dhe secili që i ka lexuar jo në pak raste, ka gjete vetveten në to dhe i ka bere pyetjen vetes: Kush jam? Ku bej pjese?

Jo vetëm të 7 kapitujt e këtij libri, por secili nga 53 nëntitujt e tij janë një leksion më vete dhe sigurisht nuk mund të rroken me një mendim apo disa mendime, që mund të jepen në një paraqitje libri, prandaj dua të ndalem në një pjese të veçante të DHUNES, siç është gjakmarrja ...

Në faqen 30, Leka shkruan: “... *Njeriu nga natyra është i pajisur me ndjenjën e hakmarrjes dhe jo të gjakmarrjes. Planëzimi i gjakmarrjes është shkalla më e larte e ligësisë së njeriut mbi njeriun. Gjakmarrja kryhet gjithmonë me gjakftohtësi dhe e organizuar deri në detaje. Është e pakuptimet dënimi alternativ për gjakmarrësit. Vetëm një drejtësi e korruptuar, pjese e një tip shteti terrorist, jep dënime alternative për gjakmarrësit. Gjakmarrja është vetëm sajese njerëzore dhe si e tille, ashtu si çdo sajese tjetër, mund të dremisë ose të ri-zgohet me gjithë egërsinë e saj. Kjo gjithmonë varet nga shkalla e sigurisë së mjedisit. Dhe siguria e mjedisit është produkt i shtetit, si sajese që është, në kohen e diktaturës u “harrua”. Dikush e mendon këtë “harrese” si pasojë të dhunës së shtetit mbi individin. Kjo është njëra ane. Ana më kryesore është se, shteti vuri nën kontroll njeriun, me të mirat dhe ligësitë e veta. Dhuna dhe Kontrolli janë dy gjera të ndryshme. Njeriun mund ta dhunosh dhe përsëri, me ose pa dashje, e le jashtë kontrollit, por dhe mund ta vesh nën kontroll, pa e dhunuar. Aty ku tipi i shtetit udhëhiqet nga parimi përça e sundo, njerëzit dhunohen, por krimi dhe korupsioni lihen jashtë kontrollit. Në raste të tilla, në mënyrë automatike, tek njeriu zgjohe instinktet e rrënjëve të vjetra për vetëmbrojtje dhe mbijetese. Mjedi helmohe dhe gjithkush fillon qërimin e hesapeve me njeri-tjetrin sipas ligjeve të natyrës apo kanuneve të lashta. Njerëzit, për çdo rast të mundshëm të sulmeve nga të tjerët, planëzojnë ligësitë e mundshme si hakmarrje. Pushka duhet afër vetes dhe e mbushur ...”.*

Kjo pjese e këtij libri, më bën të reflektoj për këtë fenomen, i cili tashme është bere tepër shqetësues, prandaj dua të shpreh disa mendime:

1-Kemi 24 vjet që populli shqiptarë në tërësi dhe në veçanti ai i veriut, dhunohet, madje po shkatërrohet në emër të gjakmarrjes, dhe ende nuk po ngrihem i dhe ti themi vetes me forcën e duhur: Ku po shkojmë me këtë mashtrim kaq të madh!? Nuk po ngrihem si duhet dhe ti themi vetes si është e mundur që e dimë se, është mashtrim dhe e pranojmë të vete-mashtrohemi?! Për të vërtetuar këtë jap një argument shume domethënës: Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtare për vitin 2013 jep raportin dhe në mes të tjerave publikon: ... *janë 600 gra të ngjuara, janë 592 fëmijë të ngjuar ... e të tjera e të tjera* ... Në biseda tavoline asnjë nuk i beson, por atje ku duhet nuk ndalemi!?

2- Menjëherë pas daljes nga Monizmi, u krijuan mjaft shoqata, që shumica e tyre ishin politikisht, në mes tyre Shoqate pas Shoqate për pajtimin e gjakut, të cilat janë grupuar në një organizatën “Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar”. Interesant! Ne, nuk kemi pas asnjëherë në histori shoqata për pajtimin e gjakut, por u mor si shembull organizimi për këtë qellim, Kosova, me Anton Çeten. Një eksperience e gabuar se, ne nuk

ishim të pushtuar; ndërsa ajo ishte e pushtuar, shoqëria kosovare ishte nën sundimin serb dhe problemet e brendshme te tyre, për të luftuar pushtuesin, do t’i zgjidhnin në baze të së Drejtës Zakonore! Tek ne, as shtresa e persekutuar nuk u ngrite të hakmerrej ndaj atyre që i kishin persekutuar, ndaj sistemit apo ndaj individit. Kjo gjendje e bën edhe më interesante krijimin e këtyre shoqatave të pajtitimit të gjakut?!

Këto shoqata, na sollën tri gjera mjaft negative: **Së pari**, drejtën zakonore pa vend në një shoqëri demokratike dhe me shtetin e vet ... **Së dyti**, një shtet brenda shtetit, duke publikuar që ne zgjidhim problemin, pajtimin e gjakut dhe jo shteti ... **Së treti**, më negativja, edukimin e brezit të ri, me mentalitetin e vetëgjyqësisë, mentalitetin e mos njohjes së shtetit ...



3-Shoqatat përfaqësojnë shoqërinë civile dhe në demokraci ato janë të domosdoshme, por krijimi i tyre duhet të bazohet në ligj. Jo vetëm në ligjin për krijimin e shoqatave, por duhet të cilësohet se, cila është baza e realizimit të misionin të saj. E theksoj këtë se, Shoqatat e pajtitimit të Gjakut nuk mund të realizojnë misionin e tyre jashtë të së Drejtës Zakonore. Atëherë lind pyetja: Në një shoqëri të caktuar, e cila ka shtetin saj, madje demokratik, i plotësuar me gjithë strukturat vendimmarrëse dhe të Drejtësisë, a duhet të funksionojë e Drejta Zakonore për zgjidhjen e konflikteve dhe në mënyrë të veçante e vrasjes? Nuk duhet.

Drejtësia, gjyqtaret, që ligjëruan këto shoqata, nuk patën në mendje se, Shoqatat e Pajtitimit te Gjaqeve nuk mund të realizonin misionin e tyre jashtë së drejtës zakonore. Për rrjedhojë, me miratimin e tyre, duke i quajtur këto shoqata persona juridik, u ligjërua funksionimi i se Drejtës Zakonore, duke e kthyer popullin, shoqërinë shqiptare në nivele primitive! Kthimin në një komunitet pa shtet dhe që duhet të drejtohet në baze të së Drejtës Zakonore!? Pra, e dhunuan popullin duke ju veshur një damke të padrejte dhe duke e quajtur popull primitiv. Kjo, jo vete që nuk është e drejte, por është e dënueshme.

4-Në analizën time, në këto 100 vjet shtet, në këto 100 vjet që jemi ndare nga pushtuesi pese shekullor, ai Osmano=turk ende jemi me mentalitete orientale të theksuara. Me këtë dua të them se, ne ende jemi me “unin” dhe me “përrjashtimin”. Me “unin” si nocion, që do të thotë se, jam unë, unë dhe prape unë, unë dhe vetëm unë. Kjo do të thotë se, me mua fillon historia dhe unë vetëvendos, unë jam shteti, që do të thotë, unë nuk e njoh shtetin ... prandaj dhe bej vetëgjyqësinë Me përrjashtimin, si nocion do të thotë: kush është kundër meje, jo vetëm që përrjashtohet, por konsiderohet armik dhe si i tille duhet asgjësuar. Kështu ndodhi në kohen e Mbretërisë, kështu ndodhi në kohen e Monizmit dhe kështu po ndodh sot, në kohen e demokracisë sonë.

Për të argumentuar këtë kemi shembullin e freskët: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me 4 maj 2005, në mënyrë krejt të

papërgjegjshëm, nxori ligjin, me nr. 9389, duke krijuar “Këshillin Koordinues për Luftën Kundër Gjakmarrjes, me në krye Presidentin e Republikës ...”. Me këtë ligj, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë ligjëroj gjakmarrjen, nxit shoqata të ndryshme që të shfrytëzojnë këtë rast për të thithur sa më shume fonde ... Në emër të këtij ligji, në mbledhje të Pajtitimit Mbarëkombëtar marrin pjese Personalitet kryesore të Shtetit tone, deri dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Presidenti e quan veten krenar që merre pjese në pajtimin e dy familjeve. Ai, e quan sukses të madh, që po funksionon e drejta zakonore në shoqërinë tone primitive, Pajtimi Mbarëkombëtar po bën një pune të lavdërueshme në këtë drejtim!!! Hajde President hajde!!! Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Presidenti i kësaj Republike ulen shume poshtë rolin e shtetit në sigurimin e shtetasve të vet ... Me këtë qëndrim, ata e quajnë popullatën shqiptare dhe në veçanti banoret e Shqipërisë Veriore primitiv, dhe ne, banore të kësaj pjese të Shqipërisë ta pranojmë pa gjë të keq se, jemi primitiv ...

Ne, po kthehemi prapa!

1-Në librin e Ismet Elezit, mbi të drejtën zakonore, në fq. 28 thekson “... *me dekretin e 30 qershorit 1928 (Zogu), për rregullimin e marrëdhënieve të caktuara juridike njithe Kanunin e Leke Dukagjinit dhe kanunin e Skënderbeut, si burim të së drejtës në një kohe kur vepronin ligjet e shtetit shqiptar* ...” Pra, pas 77 vjetësh, e njëjta gjë. Kuvendi i Shqipërisë, në shekullin XXI, ligjëron funksionimin e së drejtës zakonore, nëpërmjet të cilit të zgjidhet konflikti i krimit, duke na kthyer në një shoqëri primitive ... Dhe nuk ndalet me kaq, por vijojnë të dhunojë, duke u marre me pasojën dhe jo me shkakun. Me propozim të Avokatit të Popullit, vitet e fundit miratojnë nene shtese në Kodin Penal, për dënimin në rast gjakmarrje, duke pasur nënin për vrasje me paramendim, që është vrasja për gjakmarrje, dhe me këtë miratim ende më thelle ndikon në mendimin e një shoqërie primitive ...

Sot, ka disa shoqata për pajtimin e gjakut dhe janë bashkuar në një organizatë të Madhe, që quhet “Komiteti i Pajtitimit Mbare Kombëtar”, i cili ka me dhjetëra faqe në internet për gjakmarrje dhe deri korrespondence me Sekretarin OKB-se duke dhenë shifra të rreme, siç i theksova më sipër

Na kane ardhur dhe shoqata të huaja, për të na “rregulluar”..., Një nga këto, me 22 qershor ka filluar një marshim nga qyteti Bajram Curri dhe përfundojë në Tirane, me 1 korrik, ditën e marte, me sloganin: “**Një popull lëviz për paqen kundër gjakmarrjes**”. Drejtuesve, ju sugjerua: Shume, do të bëhen pjese e juaj, me kusht që sloganit të jete: “Një popull lëviz për paqen kundër dhunës, kundër vrasjes”. Jo vetëm ne, nuk na dëgjuan, por as Personalitetet të tjera, me reputacion të gjere publik nuk i dëgjuan, që ju bën të njëjtin sugjerim! Është e habitshme!!! Por duhet ta kemi plotësisht të qarte se, ata pa sloganin kundër gjakmarrjes, nuk mund të merrnin fondet ...

2- Edhe media jo në pak raste, pa dashje po behet jo velem një dhunues i fuqishëm, por dhe një mashtrues jo i pakte. Ajo, jo në pak raste jep informacion të pavlere, që nuk i shërben edukimit të shoqërisë. Në gazetën “Shekulli”, datë 9 maj të vitit 2003, në artikullin: “Kanuni, kushtetute, jo besëlidhje”, theksohet: “... *Kanuni është miratuar 560 vite më pare, nga 460 burra të shkolluar dhe ne e ruajmë me fanatizëm ... Në kohën e Lekës vendosen 52 bajraktarë dhe për ndryshimin e nenit “A” të Kanunit dhe për këtë qëndruan gjashtë jave* ...”. A mund të ketë dhune me të fuqishme ndaj masës së gjere se, sa te publikosh injorancën?!

A mund te ketë dhune më të madhe psikologjike, ti shkosh nënës që i është vrare vajza 15 vjeçe, viktime për gjakmarrje, me fotoreporter, me kamera dhe ta marrësh atë

ne pyetje si ne hetuesi, në interviste pas tre ditësh, kur ajo kishe nevojë vetëm e vetëm për ngushëllim, dhe ky zotëria shkon jo se kishte dhembshuri ndaj saj, por që ta shikonte ambasadori se, ne po punojmë për kundër këtij fenomeni, dhe o burra hap çantën e dollarëve apo të eurove ... Media arrin deri atje sa të publikojë opinione “Kanuni duhet te mblidhet dhe të digjet këtu në mes të sheshit”, sikur ne ishim në lëvizjen çardiste. Si mundet që në emisionin “shqip”, jo vetëm që mashtrohet, por më e madhja ishte kur në atë emision na del Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, duke thënë: E ndjeva veten shume të trishtuar kur në prehër pata vajzën e vogël të ngjuar ... A mendon kjo ministre se, sa larg është arsytimin e çështjes dhe duke qene shteti, lejon njerëzit të rrinë në arrest shtëpie pa vendim gjykate apo vendim prokurori?! Dhe aq më tepër, në ato emisione marrin vajzën e vogël dhe të recitoj poezi për kundër gjakmarrjes, që unë do ta konsideroj jo vetëm të palejueshme në anën psikologjike, por dhe një krim dhe mbi të gjitha që është vetëm një mashtrim se, vajza nuk ishte dhe nuk është e ngjuar!?

Edhe këto dite që u vra një babe i tre fëmijëve në Shkodër, nuk u vra për gjakmarrje, por mediat menjëherë dhanë lajmin, ... *në Shkodër u vra një babe i tre fëmijëve për gjakmarrje* ... Mendoj se, nuk ka dhune më të madhe se kaq ...

3- Disa lëshojmë lot krokodili për edukimin, por në fakt veprojmë ndryshe. Janë mbushur TV kryesore me telenovela turke, nëpërmjet të cilave nuk na sjellin gjë edukuese, gjë emancipuese për shoqërinë tone, përveçse edukojnë shoqërinë dhe ne veçanti të rinjtë për të zgjidhur konfliktet me vetëgjyqësi, me dhune, për mos njohje të shtetit, çka jemi pak si shoqëri të ushqyer me atë nivel emancipues .

Zgjidhja:

1-Shteti të marri urgjentisht mbrojtjen e shtetasve të vet. Madje të marri dhe kosto financiare: ne ofte se vritet ndonjë për arsye nga me te ndryshme, fëmijët e mbetur jetim t’u siguroje rritjen dhe ekonominë deri ne daljen e tyre ne jete. Ne ketë mënyrë, jo vetëm që i thotë, me vrasësin merret shteti, por do të zbus dhe mendimin për vetëgjyqësisë ...

2- Shteti me strukturat e shoqërisë civile, median, shkollën dhe gjithë shoqërinë të marri masat për edukimin e qytetareve të vet ...

3- Të shfuqizohet baza ligjore për gjakmarrje, ofte ligji nr. 9389, date 4 maj 2005, mbi krijimin e “Këshillit Koordinues për Luftën Kundër Gjakmarrjes, me në krye Presidentin e Republikës ...”; nenet e veçanta të Kodit Penal për gjakmarrjen, si dhe shoqatat e pajtitimit te gjaqeve. Kur mungon baza ligjore për gjakmarrjen do te kemi me pak raste te tilla, ne ofte se do te funksionojë shteti

Lexues të gazetës “Dukagjini”, ketë opinion mendova ta ndaje dhe me ju, duke pritur me kënaqësi mendimin tuaj. Dhe jo vetëm kaq, por ju duke lexuar ketë libër, besoj se jo në pak kapituj të tij do t’i thoni vetes: “*Unë këtu jam ... edhe këtu jam ... po, edhe këtu jam ... Si është e mundur, mos valle ky Leka ka ndeje vetëm me mua ... e të tjera e të tjera!*”. Unë u ndala në një pjese të këtij libri, në atë të gjakmarrjes. Më vjen keq se, shoqëria shqiptare po paragjykohe kaq shume, po dhunohet jashtë mase nga këta sharlatanë të papërgjegjshëm, megjithatë me duket se kështu na e ka ana ... Nuk e di, nëse e kam të drejte këtë përfundim?! Dhe një here, pres opinionin tuaj ...

Respekt, për shkrintarin, përkthyesin e publicistin Leke Imeraj dhe i uroj jete të gjate, krijimtari të reja në shërbim të së ardhmes!

Ndue Sanaj

Si ndjehet Rrogami mes Valbonës dhe Thethit?

Emri i Thethit dhe i Valbonës po lakohet shumë përmes medias së shkruar dhe asaj elektronike. Përpjekjet për zhvillimin e turizmit dhe rezultatet në rritje të këtij biznesi janë të dukshme dhe të prekshme. Të dy këto fshatra të shpallura Parqe Kombëtare, por Thethi vite përpara Valbonës, janë të njohura. Afërsia me njëri-tjetrin, interesi dhe kureshtja për të shijuar bukuritë e natyrës, bujarinë dhe mikpritjen e malësorëve të këtyre dy fshatrave, por dhe ndryshimet që po merr forma e pritjes, akomodimit dhe përcjelljes të turistëve jo vetëm shqiptarë, por dhe nga shumë vende të botës është e madhe. Me dhjetëra dhe qindra vizitorë udhëtojnë me këmbë nga Thethi në Valbonë dhe anasjelltas çdo verë, duke kaluar Qafën e Valbonës me mbi 1700 metër mbi nivelin e detit. Ndoshta shumica nga këta vizitorë nuk e dinë se sapo fillon Fusha e Gjesë dhe deri në Qafën e Valbonës, ajo rrugë përshkohet neper fshatin Rrogam me banore autokton thethjanë, që kanë banuar e jetuar breza me radhë në këtë luginë të bukur e interesante për nga bukuria dhe historia e saj. Sigurisht edhe ata, që udhëheqin guidat, qoftë vendas ose dhe të huaja, sepse edhe ata janë të pajisur sot me harta, fletëpalosje e mjete të tjera ndihmese për rrugë të tilla, pak e njohin Rrogamin, por dhe nëse e njohin nuk po dëgjohet fjalë për te, e ndoshta mos ti prishin punë vlerësimit që ka marrë Thethi e Valbona për turizëm. Por diçka ka qenë dhe është e pamundur për këdo, se të udhëtosh nga Valbona në Theth, duhet patjetër të kalosh neper Rrogam të fillosh udhëtimin nga Fusha e Gjesë me bredha shekullorë, të kalosh pranë kullave të lagjes të Alicajve, e të Gjellajve dhe pastaj të fillosh të përpjetën, për në Qafën e Valbonës. Kushdo duhet ta dijë që lumi i Valbonës burimin e ka rreze Qafës së Valbonës, dhe katarakti i këtij lumi i bukur dhe i përhershëm ndodhet poshtë këtyre burimeve me ujë të ftohtë e të kulluar. Qafa e Valbonës, burimi i Valbonës, katarakti i Valbonës ndodhen në veriperëndim të fshatit Rrogam. Po një gjë është interesante se, uji pasi derdhet nga katarakti, humbet në kohën e verës poshtë zallit që kalon përmes Rrogamit dhe shfaqet në fund të Fushës së Gjesë, ose fillim të luginës së Valbonës. Neper shtratin e lumit që kalon neper Rrogam ujë ka në stinët me shira ose kur shkrin bora. Lugina e Rrogamit është vazhdim i luginës së Valbonës me bukuri të rralla natyrore, me florë dhe faunë të larmishme. Është në interes të thethjanëve, banorë të Thethit, por dhe të rrogamaxhive thethjanë, të dashuruarve të këtij komuniteti, që të flitet të shkruhet dhe vlerësohet Rrogami, historia, e sotmja dhe perspektiva e tij.

Figura dhe personaliteti i Cam Dedës të Alicajve që qe fillesa e historisë së Rrogamit të Thethit, lidhja me të parët e shtëpisë së Lul Gjokës të Gjellajve është interesante dhe e bukur të dihet. Pse ky Cama zgjodhi si ortak të kësaj bjeshke shtëpinë e Lul Gjokës e jo ndonjë tjetër nga Margjelajt, Ndreajt, Gjeca-jt apo Vuksanajt, që është edhe me ata shokë, kumar e dashamirë? Rrogami ka nevojë të njihet me toponimet që ka duke i rifreskuar, por edhe ekspozuar bashkë me simbollet që duhet ta dallojë atë nga një komunitet tjetër. Turisti dhe udhëtari duhet të dijë ku fillon fshati i Rrogamit, qoftë nga hyrja nga Valbona apo nga Thethi. Kushdo që sapo kalon Valbonën dhe futet në Fushën e Gjesë, kur informohet që fillon Rrogami, që është banuar dhe banohet nga thethjanët edhe Thethi u duket më afër edhe qafa e Valbonës më e ulët për t'u kaluar e do të ndjehet më të lehtësuar.

Më parë se kushdo. secili duhet të përpqet për të njohur, rritur e ekspozuar vlerat e veta, të vendit ku ka lindur vet dhe të parët e tij, ku ka tokën, vendin e varret e të parëve. Kanë meritë të madhe ata thethjanë që banojnë në Rrogam, që pas viteve 90-të qenë të parët që filluan të investojnë dhe po investojnë për zhvillimin e turizmit në Valbonë, siç është Kol Gjoni, Mirash Lamthi e të tjerë. Këta meritojnë vlerësim, por dhe ndihmë e bashkëpunim përmes shoqërisht turistike që vizitojnë Thethin e thethjanët, janë të njohur e të shkathët për vetë historinë që daton gati një shekull të fillimi të turizmit në Theth.

Rrogami meriton të vlerësohet, të ndihmohet dhe të studiohet. Më parë se kujt do ata që kanë lidhje me Rrogamin interesa trashëgimie dhe objektiva afatgjata. Ndoshta burrat e vjetër që kanë banuar në Rrogam dhe janë me kujtesë të pastër flasin, kalemxhinjtë, që i ka të spikatur ky komunitet shkruajnë, e dikush që ka bere lekë dhe për fat edhe nga këta ka, mund të kontribuojnë e duke bashkuar këto vlera krijohet mundësia për punë të mira për këtë fshat. Brezat që do të vijnë kanë nevojë dhe interes të njohin edhe Tush Gjonin që nuk e pati njohur as Cam Deda e të parët e shtëpisë të Lul Gjokës. Ndarja e re territoriale ndoshta ka me sjellë dhe forma e metoda të reja administrative, por kushdo po kërkon e do të kërkojë vatanin e babës dhe të gjyshit, pavarësisht se ndoshta duhet të shikojë vite e dekada prapa, e kur nuk janë të njohura, të shkruara e të evidentuara bëhen të vështira për tu ditur e ndoshta me konflikte me individ apo ligjet e kohës.

Rrogami mes Thethit dhe Valbonës ndjehet mirë dhe siç thotë populli “E ke lehte e jo të vështirë kur vëlla e komshi ke të fortë e të mirë”.

Zef BARI



NDAHET NGA JETA DILA NDOJA ANËTARE NDERI E SHOQATËS “ATDHETARE DUKAGJINI”

Para pak ditësh u nda nga jeta zonja Dila Dedë Ndoja, në moshën 71 vjeçare. Dila u lind në një familje me tradita atdhetare në fshatin Lekaj të Shalës. Ajo që në fëmijëri ndjeu mbi supet e saj peshën e rëndë të kohës, varfërisë, punës në bujqësi e blegtori. Martohet në Theth në njërin nga familjet më të mira të këtij fshati, në shtëpinë e Ndoj Mirakës, me Dedë Ndojën. Nuk qe e thënë që të kishte një jetë normale, megjithëse me bashkëshortin, dhe gjithë familjen e tij kishte marrëdhënie shumë të mira, e gjithashtu edhe me të gjithë farë e fisin ku lindi dhe ku jetonte. Një re gjithë rrufe e shkrepitimi u qëndroi mbi krye kësaj familje, si edhe shumë të tjerave në këtë fshat, por edhe në të gjithë vendin, reja e persekucionit komunist, i cili godiste pa mëshirë kundërshtarët e atij sistemi.

Arrestohet bashkëshorti i Dilës, dënohet dhe pasi kryen dënimin nuk lejohet të shkon-te në shtëpi, por internohet familjarisht në Lushnjë. Kjo nuk ndodhi një herë, por dy herë burg politik dhe dy herë internime familjare. Të gjithë këto, megjithëse shumë të vështira për tu përballuar, nuk e mposhtën këtë familje, por mbijetoi me nderë duke i përballuar gjithë kalvarin e këtyre vështirësive. Kjo familje i përballoi këto vështirësi pasi ishte shumë e qëndrueshme, e ndershme, e pathyeshme nga presionet, lëmoshat apo lajkat. Sa pa dritën e demokracisë ndahet nga jeta Deda, bashkëshorti i Dilës. Ndërsa këto ditë ndahet nga jeta edhe Dila. Ky çift u largua nga kjo jetë me nder dhe respekt nga të gjithë të afërmit, miqtë dhe dashamirët, nder dhe respekt të krijuar çiltërsisht nga ky çift dhe të gjithë pjesëtarët e familjes. Por duhet të kujtojmë se të dy ikën nga kjo botë pa marrë shpërblimin e merituar moral dhe material për vuajtjet e pashoqe të së kaluarës së persekucionit komunist.

Jeta e tyre bashkëshortore dhe familjare pati lëvizje e persekucione të shumta, nën tytat e armëve të policisë me uniformë apo pa uniformë. Në internim, në Lushnjë, filluan lindjen e fëmijëve.

Edhe pas kthimit të fundit në shtëpinë e tyre, nuk e patën të lehtë, sepse pothuaj çdo gjë ishte shkatërruar. Ata me durim, me duart e arta të Dedës dhe ndihmën e Dilës, sepse fëmijët ishin të vegjël, mund të ngrënë jetesën nga e para.

Me gjithë këto vështirësi, me gjithë moshën që po rritej dhe pleqëria po afronte, Dila asnjëherë nuk u ankua, nuk bëri viktimën, por tregoi vendosmëri për të forcuar shtëpinë, për të rritur fëmijët, për ta pas nderë e dinjitet në shoqëri.

Dila Ndoja ishte një grua e fortë, e vendosur për jetën dhe familjen, punëtore gojëkrycur sepse kështu ishte kohë për ata, shumë e kujdesshme në familje, gojëmbël me të madhin dhe të voglin dhe shumë e pritur në shtëpi.

Ndarja nga jeta, nga fëmijët e saj, tash ata janë rritur e martuar dhe kanë familjet e tyre, por gjithsesi për prindin fëmijët, fëmijë mbeten gjithmonë, ishte një dhimbje e madhe, sepse kujtohen vuajtjet, persekutimi, keqtrajtimi politik, vështirësitë ekonomike e shoqërore nëpër të cilat kaloi kjo familje.

Dila dhe bashkëshorti i saj, Deda, i edukuan fëmijët e tyre me dashurinë për punën, përballimin e vështirësive, ndjenjën e tolerancës dhe faljes së persekutorëve dhe përndjekësve politike, i edukuan me qëndrueshmërinë, burrërinë, vendosmërinë. Ata i edukuan fëmijët e tyre, që, megjithëse në kushte të jashtëzakonshme, dhe asnjë herë nuk i nxitën për hakmarrje, por i edukuan me ndjenjën e mirëkuptimit, i edukuan me dashurin dhe respektin për bashkëfshatarët e vet, shokët dhe miqtë.

Duke vlerësuar vështirësitë që ka kaluar kjo familje dhe konkretisht edhe vetë Dila, Shoqata “Atdhetare Dukagjini” e ka shpallur atë “Anëtare Nderi të Shoqatës Atdhetare Dukagjini”.

Ne jemi të bindur se, fëmijët e Dilë dhe Dedë Ndojës do të vazhdojnë traditat më të mira të trojeve të shtëpisë së Ndoj Mirakës dhe Sadri Lukës.

Dila Ndoja u përcolle me të gjitha nderimet për në banesën e fundit.

Pushoftë në Paqe.

Ndue Sanaj, Roza Pjetri, Gjergj Leqeja, Luigj Shyti, Anton Kosteri, Syka Çarku



PUBLIKU MË OBLIGON TË INTERPRETOJ SA MË DENDËSISHT!

BASHKËBISEDIM ME KËNGËTAREN DHE AKTOREN, LUDMILLA BABALLËKU

- Unë kam një bindje brenda vetes, se nëse e ushqen, e edukon dhe përpiqesh ta mbron atë që ti e ke ndërtuar me një punë profesionale, asnjëherë nuk del huq!

- Të jesh këngëtar, sikurse edhe çdo profesion tjetër, kërkohet mund, punë, djersë - tre komponent të domosdoshme që shpiten tek e bukura, e mira dhe tradicionallja, nga e cila edhe pret populli! - shprehet ndër të tjera gjatë bashkëbisedimit, Ludmilla Baballëku.

... Kur flet e bisedon, duket se zërin e nxjerr me nota muzikore! Edhe kur është jashtë skene, ka qëndrim artistik e interpretues!... Është bujare, zë ëmbël, modeste, vitale, elegante, e lehtë në komunikim, e gatshme për të bashkëpunuar e kënduar me gjithsecilin këngëtar a këngëtare, artiste e kompletuar me të gjitha virtytet njerëzore e humane ... Janë vetëm disa nga atributet karakteristike meritore që ka këngëtarja dhe artistja e teatrit "Petro Marko" të Vlorës, Ludmilla Baballëku, që shkurt e thërrasin me emrin përkëdhelës Ludi ...

Me zonjën Ludmilla Baballëku, u njoftova në Gjirokastrë del Montello të Trevisos, ani se me emrin dhe zërin e sajë jam njohur nga shtypi, radio e televizioni vite ma parë. Për të më kishin folur edhe disa miq e mikesha që jetojnë e veprojnë bashkërisht këtu në Itali. Dhe, nuk e humba rastin që t'i kërkoja një intervistë, të cilën më pas ashtu sikur ram dakord e realizuam në zyrën e zonjushës Ermira Zhuri, aty ku është edhe selia e Shoqatës ILIRIA Treviso.

Zonja Ludmilla, mund të na tregoni në pika të shkurta profilin tuaj?

Hë, profili im! E para, ju faleminderit për bashkëbisedimin që po më kërkonit. E dyta, një falënderim të madh ia adresoj Ermirës (Zhuri) për ndihmesën që ka dhënë në ardhjen time me festën e Fondacionit Nermin Vlora Falaschi dega e Italisë (Treviso) si dhe ftesën që të përfaqësohem me Shoqatën ILIRIA në Festën e Gjirokastrës. Nuk mund ti anashkalojë pa i falemenderuar edhe Vitorë Stefa Leka dhe Mardena Kelmendin. Profili im është shumë i thjeshtë, kam mbaruar kanton, vazhdojë profesionin tim që e kam pasion d.m.th. si këngëtare. Ndihej shumë rehat që ushtroj kë këtë profesion. Jam vajzë Beratit, lindur, rritur e edukuar aty, ku kam filluar të punojë në teatrin e qytetit dhe nga aty kam kaluar në vitin 1989 në Vlorë, ku ndjehem shumë mirë. Bëj jetën time artistike pran teatrit "Petro Marko" si aktore e dramës dhe këngëtare e teatrit variete ...

Fillimisht më intereson, kur ke filluar të këndosh?

Ashtu si çdo fëmijë edhe unë kam kënduar si e vogël, qysh në kopsht. Pastaj vijova në festivalet për fatosa e pionier ... Ndërkohë pas mbas mbarimit të

tetëvjeçares, unë shkova për tu edukuar në muzikë te shkolla e mesme artistike, mandej në studime ... dhe tani jam ajo që jam sot - këngëtare!

Zërin e bukur, e ke dhunti natyrore, trashëgim familjar, apo nevojë për të mbijetuar?

Ju faleminderit për këto fjalë të bukura! Sigurisht që ky është profesioni im, dhe çuditërisht mbetet një nga produktet që më mban me jetën, se unë nuk kam ndonjë profesion tjetër, dhe kjo ka bërë që unë asnjëherë skam lëvizur nga Shqipëria, lëvizjet e mia kanë qenë vetëm në koncerte, koncerte ... kjo është e tëra, pos aktivitetit tim që kam në teatër si me



trupën e variete ashtu edhe me trupën e teatrit ... Unë kam një bindje brenda vetes, nëse e ushqen, e edukon dhe përpiqesh ta mbron atë që ti e ke ndërtuar me një punë profesionale, asnjëherë nuk del huq. Përndryshe e kam të qartë se nëse abuzohet vokalisht, nëse abuzo-



het me çfarëdo produkti që do ti japësh këngës, asnjëherë nuk do të jete fitimprurëse. Mbase këto rrymat e reja që kanë ardhur e kanë hyrë padrejtësisht në muzikën tonë shumë të bukur, iu kanë sjell shumë fitime këtyre të ashtuquajtur këngëtar. Të jesh këngëtar, sikurse edhe

çdo profesion tjetër, kërkohet mund, punë, djersë. Janë tre komponent të domosdoshme që shpiten tek e bukura, e mira dhe tradicionallja, nga e cila edhe pret populli. Është tamam si me gjuhën, nëse ti nuk e interpreton gjuhën tënde, si mund të presësh se gjuha e huaj është më e mirë se gjuha jote! ...

Nga fëmijëria, që kur ke filluar të merresh me këngën, cilat janë sukseset?

Kënga më ka frymëzuar e më frymëzon vazhdimisht, andaj e konsiderojë si suksesin kryesor! ... Përndryshe, si fëmijë e konsiderojë se të gjithë ishim të mrekulueshëm. Por vlerat vërehen që në fëmijëri, kjo ka bërë që talentin tim ta vërejnë të tjerët dhe të më angazhojnë me këngën, të shkollohesha e ta përsosja edhe me shumë vlerat e talentit. Paralelisht me shkollimin angazhohesha edhe nëpër festivale, fillimisht në ato për fëmijë, mandej të rritur e deri në Festivalin i Këngës në RTSH, që ishte synimi i çdo këngëtarit. Në këtë festival kam marr pjesë që në vitin 1984, në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare, me dy këngë të muzikës së lehtë, si nxënëse e shkollës së mesme, ku njëra prej tyre u vlerësua si e treta. Në këtë festival rregullisht kam marr pjesë deri në vitin 1995, kur ndryshuan gjërat, festivali bëhej në plejbek, u bë komerc, duke e prishur fizionominë e këngës shqiptare, dhe kjo nuk më pëlqen, andaj kam hequr dorë të marre pjesë ...

Cilat janë këngët e tua të preferuara?

Të gjitha këngët e mirëfillta shqiptare i këndojë, por si më të preferuara, nëse më lejohet të shprehem janë këngët Beratase, nga qyteti im i lindjes. Këngën nuk e shfrytëzojë për komercë, atë e inter-

Këngët tua që i interpreton, i shkruan tekstet vet, apo bashkëpunon me autor tekstesh?

Jo, absulitisht nuk i shkruaj, unë vetëm i interpretoj. Sigurisht që kam bashkëpunuar dhe bashkëpunoj me autor tekstesh dhe kompozitor. E kam të madhin Gjon Beci, i ndritë shpirti se u bë për rahmet, mandej kam Jorgo Papingjin, të cilin e kam mik, e të tjerë. Ndërsa si kompozitor kam Aleksandër Peci, Tish Daia, Naim Gjoshi, Ruzhdi Keraj, e shumë e shumë emra të tjerë. Përpos asaj të muzikës qytetare që unë dua ta vlerësojë një nga edukatorët e mi, që ka bërë një punë kolosale për të më brumosur që nga familja ime, është im at- Mojsi Baballëku, një nga aktorët dhe regjisorët që i ka vu themelet e teatrit variete të Beratit, e shumë emra të tjerë që kontribuar të jem kjo që jam.

Me këngën "Shqipëri nëna ime" në festivalin Gjavora '14, te mërgimtarët ke sjellë emocione të vërteta. Ju si jeni ndier?

Kam thënë edhe ma parë edhe po e përsëris, se publiku më detyron të interpretoj, në këtë rast edhe shqiptarët e pranishëm që ishin prezent më sollën vërtet edhe mua emocione të pa përhueshme. I vëreja të përloitur, edhe unë jam emocionuar e përloitur ... Ndiheja edhe përgjegjëse, sepse për herë të parë kam kënduar para një publiku kaq shumë nacional, ku ishin prezent evropian, amerikan, aziatik dhe afrikan ... Se çdo këngë unë, mundohem ta këndojë dhe shpalos para publikut me vlera origjinale duke i kompletuar komponentët e saja, si: teksti, muzika dhe interpretimi.

Pos si këngëtare, cilin profesion tjetër e ushtroni?

Ne, këngëtarët interpretimin e kemi profesion. Të kënduarit është interpretim sikurse edhe aktrimi, andaj nuk e kam kurrar vështirësi të paraqitem në role artistike. Unë kam filluar me këngën në qytetin tim të lindjes në Berat. Mandej kam kaluar në Vlorë, ku kam pasur fatin ta takoja te madhin Bert Delia, drejtorin e teatrit të Vlorës, i cili më ka ndihmuar shumë, për çka i falënderohem pa masë. Tani jam paralelisht në Teatrin e Dramës dhe Teatrin e Varietesë së qytetit të Vlorës. Jam akoma aktive, për shembull, sa jam këtu e kam humbur një premier, e cila në mungesë timen është shtyr për muajin shtator. Krahas Teatrit të Vlorës, sipas nevojës angazhohem edhe në teatrin e Beratit.

Ke jetuar në migracion, gjegjësisht ke njohuri për migracionin?

Jo! Në migracion nuk kam jetuar asnjëherë, sepse isha dhe jam rehat aty ku jam. Kam një punë shteti, ashtu sikur thash më lartë, punojë në teatër, gjithmonë më ka ardhur keq që ti largohem profesionit tim. Merrem edhe me këngën si e pa varur, me fjalë tjera asnjëherë nuk kam pasur nevojë të jetojë në migracion

.... E di se njeriu për halle del jashtë atdheut, për të siguruar ekzistencën dhe kushtet jetësore. Nuk besojë se në migracion delet për aventurë, për mendime e veprime të mbrapshta ... Për migracionin sigurisht se kam njohuri, më ka mundësuar edhe koncerte që kam pasur jashtë nga viti '95, si në Holandë, Belgjikë, Gjermani, Itali, e të tjera. Por, koncerte me Ansamblin e Beratit kam pasur edhe në kohen sistemit në Turqi, ku jemi mirëpritur gjithkund se, kemi pasur paraqitje, sepse kemi prezantuar vlerat absolute jo vetëm të qytetit tim, po gjithë shqiptare, si me këngë, valle, veshje, kulturë, e të tjera.

Në Kosovë dhe viset tjera shqiptare, keni pasur paraqitje?

Po! Do ta fillojë me Kosovën, gjegjësisht me qytetin e bukur të Prizrenit, i cili me vendlindjen time Beratin, kanë ngjashmëri në mes veti dhe janë të binjakëzuar. Atje isha me grupin e Beratit, mandej edhe me të Vlorës, prapë me të Beratit ... Në Klinë si pjesëmarrëse e disa hershme e festivalit **"I këndojmë Lirisë"**, ku jam shpërblyer me çmimin e parë. Në Kaçanik gjithashtu u shpërbleva me vendin e parë. Ndërsa, në Suharekë në Festivalin e teatrove, me trupën e Teatrit të Vlorës kemi performuar me komedinë **"Krushqit nga Vlora"**, ku isha aktore edhe unë, u nderuam gjithashtu me çmimin e parë. Më duhet të falënderoj mikpritjen e mrekullueshme që kam hasur në Kosovë, sidomos në Klinë dhe Suharekë, po



edhe kudo që jemi paraqitur. Në Mitrovicë isha edhe me Fondacionin Nermin Vlora Falaschi, e gjithashtu jam e ftuar (brenda mundësisë do të jem) në gushtë të marr pjesë në një festë familjare - martesë që do të ketë njëra nga anëtarët e grupit artistik të Shoqatës ILIRIA. Në Maqedoni kam qen shumë herë, në Shkup, Tetovë, ku kam marr edhe shpërblime. Në Strugë shkojë çdo herë verës pasi kam një nostalgji të veçanët për klimën absolute që ka Struga. Në Maqedoni kam shkuar edhe nëpër dasma e festa (gezime) familjare, që gjithherë kam kaluar mrekullisht. Në Luginën e Preshevës nuk kam pasur rastin deri më tash

Në Itali jeni për herë të parë, apo...!?

Në Itali kam qen edhe ma parë qysh në vitin '95-të ku kemi performuar me javën kulturore të qytetit tim të lindjes Beratit, në Lece, Otranto, Toranto, e të tjera. Ndërkohë, në vitin 2000 kam qen me parodistat e Vlorës në Perugia, Romë, e disa qytete të tjera, ku kemi pasur paraqitje në salla të mëdha të stërmbushura me shqiptar. Para dy viteve isha në Verona. Ndërsa tani jam këtu për herë të parë, ku Fondacioni Nermin Vlora Falaschi, pat një

aktivitet, ishte prezent edhe ambasadori Neritan Ceka me zonjën e tij, Mardena Kelmendi, e të tjerë. Së bashku me bashkëvendësen time Vitoren, siç e quani ju Nënëloke dhe Mirën -presidenten e Shoqatës ILIRIA, morëm pjesë në dy aktivitetet në Kopër të Sllovenisë. Pata paraqitje në Festivalin RITMET E VALLET E BOTËS në Gjirokastrë së bashku me grupin artistik të Shoqatës Iliria. Besojë se edhe paraqitja ime nuk i ka zhgënjyer. Ndërsa unë jam ndier shumë e relaksuar dhe kam kaluar mrekullueshëm ku do që jam paraqitur për çka i falënderoj shumë, shumë ... të gjithë, mos të përmend emra se mund ndonjë ta harrojë e do ti hyja në hak.

Mendimi i juaj për aktivitetin e Shoqatës ILIRIA të Trevisos?

Të jem e sinqertë ma parë nuk kam pasur njohurit e duhura për këtë shoqatë. Më kanë treguar koleget e mia të Fondacionit Nermin Vlora Falaschi nga Tirana, si: Zenepeja, Irini, Rosa, Teuta, Vitorja, ... por tani, atë që e pash dhe e përjetova për disa ditë, njohurit e mia për aktivitetin e Shoqatës janë të kompletuara. Kam vërejtur se aty zhvillojnë aktivitetet shqiptarë nga Shkodra e Shkupi, nga Berati e Prizreni, nga Durrësi e Prishtina .. tamam si një Shqipëri pa kufi administrativ. Kam vërejtur se ka këngëtar me cilësi të larta si: Gjellosh Hajdari, Gjin Shani, mandej vogëlushja Kristina Hajdari, nga e cila pritët shumë, valltarët të udhëhequr nga familja Kurti e të tjerë, të gjithë këta jo vetëm që zhvillojnë aktivitetet pa kompozim material, por i shpenzojnë edhe mjetet e tyre personale, vetëm e vetëm që të e prezantojnë kulturën e traditën shqiptare, që e kemi shumë të pasur e me vlera. I përgëzojë të gjithë, e njëkohësisht i falënderoj të gjithë për mikpritjen që ma servuan gjatë qëndrimit disa ditësh këtu, e një falënderim i veçantë i takon Ermira Zhurit, presidente e Shoqatës ILIRIA dhe Fondacionit për Itali.

Keni ndonjë plan për të ardhmen?

Plane të mia personale nuk kam dhe nuk mund të bëjë, pasi punojë në një trup teatri, i cili ka planet vjetore. Kur kam nevojë të paraqitem individualisht diku, sikur tani që jam këtu, kam mirëkuptimin e drejtuesve të teatrit, prandaj iu jam mirënjohës. Motoja e ime është ta kënaq publikun gjithherë dhe për derisa interpretimi më frymëzon, publiku më detyron të paraqitem sa më denjësisht ...

Pata kënaqësinë që zhvilluam një bashkëbisedim. Në fund cili është mesazhi për lexuesit?

Kënaqësia është e ndërsjellë ...! Unë, ju urojë gjithë të mirat shqiptarëve kudo që janë, edhe lexuesve të shkrimeve tuaja dhe të këtij bashkëbisedimi. Ne jemi miq të përkohshëm në këtë botë. E di se çdo kush e ka nga një dëshirë të veçantë, andaj iju dëshirojë ta realizojnë, të kenë dashuri e harmoni në mes vete ...!

Duke iu falënderuar për këtë intervistë, në emrin tim dhe të lexuesve ju urojmë që ky vitalitet i juaji të jetë në vazhdimësi i tillë. Shëndet!

Bashkëbisedoi **Beqir M. Cikaqi**
qershor 2014, Treviso

URREJTJA



Psikologu amerikan Sternberg e mendon urrejtjen si rrezik të paqes njerëzore. Ai thotë: Deri më sot psikologët kanë thënë shumë pak mbi natyrën dhe prejardhjen e urrejtjes, duke e krahasuar këtë me arritje të tjera si kujtesa, perceptimi dhe mbi të gjitha, paragjykimin... Psikologët, moralisht, janë të detyruar të na shpjegojnë urrejtjen, shkaqet dhe pasojat e saj dhe si mund të luftohet, për të arritur një kulturë paqësore. Urrejtja është një emocion njerëzor që shfaqet në formën më të ashpër të antipatisë. Si ndjenjë e "egër", shfaqet në formën e injorimit, përbuzjes, neverisë dhe armiqësisë. Motivet e urrejtjes janë të pavetëdijshme, por, mund të jenë edhe të vetëdijshme. E kundërta e urrejtjes, me po aq fuqi vepruese, mendohet dashuria.

Urrejtja nuk lind dhe për më tepër, nuk zhvillohet, tek hiçi dhe nga hiçi. Në radhë të parë, ajo lind dhe zhvillohet aty ku hakmarrja për dhimbjet e shkaktuara nuk është kryer. Urrejtja është një formë "dueli" midis arsyes dhe ndjenjave. Shpesh ndodh që ndjenjat "rebelojnë" dhe nuk i binden arsyes. Veçanërisht kjo kur ndjenjat janë dhunuar rëndë dhe si pasojë është zhvilluar ajo e urrejtjes. Nëse është zhvilluar i gjithë "cikli" zemërim, tërbim, inat-urrejtje, arsyeja e ka të vështirë fitoren.

Në kuptimin filozofik, sipas Kirchner dhe Michaëls, urrejtja është antipatia e thellë ndaj asaj që na ka shkaktuar pakënaqësi. Urrejtja, si e kundërta e dashurisë, nuk mjaftohet vetëm me neverinë ndaj keqbërësit të mundshëm por, domosdoshmërisht me dëmtimin e tij dhe, sa më shumë.

Fromm dallon dy lloje urrejtje: Urrejtjen reaktive dhe urrejtjen si element përbërës i karakterit.

Urrejtja reaktive është gjithmonë pasojë e një dhunimi ose e një situatë dhimbjeprurëse, përballë të cilave njeriu ndodhet i pafuqishëm për të reaguar. Fromm thotë se, me urrejtje reaktive unë kuptoj një reaksion emocional që shkaktohet si pasojë e një sulmi mbi jetën time, sigurinë time, të idealeve të mia ose, ndaj personave të tjerë të cilët unë i dua apo jam identifikuar. Urrejtja reaktive ndodh gjithmonë tek ata njerëz që karakterizohen nga qëndrime pozitive për jetën, për njerëzit dhe që kanë ideale të qarta. Ai që karakterizohet nga

optimizmi i fortë për jetën, reagon fuqishëm në rastet e rrezikimit të dinjitetit dhe interesave të tij jetike.³³

Urrejtja si element përbërës i karakterit, shfaqet në të njëjtën mënyrë dhe formë si ajo reaktive por, ndryshimi është se në këtë rast, mendohet si natyrë e karakterit të njeriut, si qenie brenda tij. Reaksioni i urrejtjes vjen nga ndjenja e antipatisë, që gjendet brenda njeriut. Në rastin e urrejtjes reaktive, reaksioni i urrejtjes shkaktohet nga situata konkrete, në vendin dhe kohën e caktuar ndërsa, në rastin e urrejtjes, si element përbërës i karakterit, armiqësia ndaj të tjerëve nuk varet nga situata. Njeriu me natyrën e karakterit dashakeqëse, është i predispozuar për urrejtje, pavarësisht nga intensiteti i ngacmimeve të jashtme. Në mënyrë metaforike ai krahasohet me një vullkan që e mban zjarrin brenda deri në shpërthim por, që nuk dihet as se kur shpërthen dhe as sa herë shpërthen. Aktivizimin e urrejtjes si element i karakterit në popull, Fromm e mendon si mjetin më të rëndësishëm për mobilizim për luftë. Urrejtja mund të shfaqet si ndjenjë dhe afekt dhe si e tillë ajo mund të jetë e kufizuar dhe e pakufizuar.

Urrejtja e kufizuar (matur) është relative dhe e kontrolluar. Ajo është pjesë e përditshme e jetës tonë dhe lidhet me zemërimin, xhingosjen, inatin, premisa këto të urrejtjes. Njeriu i civilizuar, zakonisht, mbetet tek urrejtja e matur të cilën ai e mban vazhdimisht nën kontroll. Ai e ka të vështirë që të urrejë të tjerët dhe botën rreth vetes pa arsye të forta. Ai, megjithëse është i bindur se rreth vetes ka shumë "armi", prapë nuk ka frikë nga prania e tyre. Urrejtjen jashtë kufirit ai e mendon të dëmshme. Do të ndeshet me inteligjencën dhe civilizimin e tij, gjë kjo që ai nuk ja lejon vetvetes. Ai krahason armikun me mikun dhe mendon se, në thelb, të dy janë njerëz.

Urrejtjen e civilizuar ne e ndeshim përditë, të kombinuar me ndjenjat e tjerë dhe efektet e shkaktuara nga antipatia. Antipatinë ne shpesh e ngatërrojmë me urrejtjen. Antipatia është premisë që të çon në urrejtje por, nuk është vetë urrejtja. Nëse dikush, me të cilin ne jemi ulur në tavolinë, kafshon thonjtë, kruan hundët apo sillt si asocial, duke na shkaktuar reaksione dhe efekte deri në antipati, kjo nuk do të thotë se ne e urrejmë atë. Ai mundet të jetë i afërm i yni ose njeri shumë i mirë i cili vuan nga vese të këqija. Veset e këqija të tjerëve, të cilat nuk na dëmtojnë ne dhe as nuk na prekin direkt, janë shkak për antipati ndaj tyre por, jo burim urrejtjeje.

Përballë urrejtjes së civilizuar, si kala e pamposhtur, qëndron urrejtja e pakufishme, urrejtja absolute. Urrejtja absolute, barbare, hyn në fuqi menjëherë kur njeriu rrezikohet seriozisht dhe kur ai mendon se, liria dhe të drejtat e tij, janë vetëm një frazë boshe. Njerëzit që vuajnë nga urrejtja si element përbërës i karakterit, kur shpërthejnë në urrejtje, nuk dinë të ndalen. Ata

Burrnesha e Dukagjinit ZOJË MUSTAFJA

Shumë shkrime, këngë, vjersha dhe studime janë bërë për Dukagjinin. Por asnjëherë nuk ju vjen fundi shkrimeve, pasi kjo zonë ka aq shumë vlera historike sa që do duhen vite e vite për ta studiuar hollësisht këtë krahinë legjendare të Shqipërisë. Ndryshe nga shumë shkrimtarë të tjerë të cilët shkruajnë dhe përsërisin gjithmonë të njëjtat fjalë, rreth një heroi apo luftëtari unë desha të ndalem te një figurë shumë e rëndësishme dhe e veçantë për zonën tonë. Është fjala



për Zojë Mustafen. Zojë Mustafja u lind në fshatin Theth, në një familje mjaft të njohur dhe të nderuar nga i gjithë Dukagjini. Ajo kishte fatin të ishte nga dera e trimit Pjetër Gjoka. Zoja u martua në Shosh në lagjen Gurrë me Mark Lulashin. Nga paraqitja të dukej se kishte tiparet e një gruaje të rreptë, të ashpër dhe të egër por ishte komplet e kundërta. Ajo ishte një grua e gjatë, pak e dobët, me

tipare burrnore dhe shumë fisnike. Ishte shumë e rreptë ndaj rregullave tradicionale të trevës së Dukagjinit. Por përveç këtyre ajo kishte edhe një zana, profesion apo një dhunti me cilën u bë mjaft e njohur për kohën që ajo jetoi. Zoja ishte vajtare. Me talentin e saj në të krijuar ajo do të arrinte shumë larg. Kishte një zë të lart, piskamë, si dhe kishte një mënyrë të vajtuarit tepër të veçantë. Me kalimin e kohës ajo do bëhej shumë e njohur për të gjithë Dukagjinin. Ja filloj me vajtme në Shosh për të vazhduar më pas në Shalë, Nikaj, Mërtur, Kir, Theth, Toplanë, Prekal dhe kështu me radhë në të gjithë Dukagjinin mbarë si edhe jashtë ti. Ne kohën që ajo jetoi i takoj të përjetonte edhe sisteme të ndryshme dhe një nder ta dhe me i keqi do ishte edhe sistemi komunist. Në Dukagjinin ky sistem do bënte shumë dëme. Njerëzit kishin ndryshuar, të gjithë kishin frikë edhe nga njeri tjetri. Por kishte edhe nga ata që nuk pranuan ti nënshtroheshin këtij sistemi. Për momentin po cilësoj vetëm disa për ta lidhur pastaj edhe me një histori që më vonë do lidhej me Zojë Mustafen. Këta persona që guxuan të kundërshtonin qeverinë dhe të kërkonin të drejtat e tyre ishin shtëpia e flamurtarit të Shoshit. Këta burra me në krye flamurtarin do luftonin dhëmb për dhëmb me bishën komuniste. Kjo luftë do vazhdonte gjatë dhe për pasojë do kishte edhe shumë viktima. Në këtë luftë shtëpia e flamurtarit do humbte plot 13 burra. Një ndër ta do ishte edhe vet flamurtari. Me humbjen e flamurtarit Shoshi do niste një gjamë të madhe. Në këtë gjamë nuk kishte se si të mos thirrej për të vajtuar vajtorja tashmë e famshme Zojë Mustafja. Këtu jeta e saj do merrte një tjetër rrjedh. E mbushur me mllëf, inat, dhe mërzë në këtë vajtme ajo do dilte jashtë koordinatave të saj ku në një pjesë vajtmi ajo shanë dhe mallkon qeverinë,

at qeveri që i mori jetën flamurtarit dhe meshkujve te tij. Kjo gjë i mërziu tej mase komunistët dhe në këtë mënyrë ata do bënë edhe arrestimin e saj. Pra gruaja sokoleshë do të prangosej tamam siç prangosen trimat. Ngjarja e saj do të merrte përmasa edhe më të mëdha duke qenë si ishte diçka shumë e radhë që një grua të burgosej. Por kjo gjë nuk e mposhti burrneshën ajo mbeti e tillë edhe pas daljes nga burgu. Pa asnjë frikë apo hezitim ajo do vazhdonte rrugën e lënë përgjysmë, tashmë edhe më e fortë. Në pak rreshta kjo ishte historia e një gruaje dukagjinase e cila dha shumë për Dukagjinin dhe do mbetet e gjallë dhe pavdekshme deri sa të ekzistojë emri Dukagjin.

Dukagjin shumë për ty shkrova,
Tanë heronjt n'kangë ti knova,
Ju kam knue trimave që dhanë jetën,
Tuj luftu, me mbrojt fe me mbrojt kanu,
Me mbrojt trojet prej pushtimit,
Qysh në kohë t'Lek Dukagjinit,
Ju kam knue trimave t'motit,
Mehmet Shpendit - Lulash Gjeloshit,
Ndok Gjelo - Ndue Deli,
Marash Tuc - Qerim Deli,
Kol Mark Kola dhe Mark Lula,
Njaj Pal Gjoka burr ndër burra,
E shumë t'tjerë burra me rradhë,
Që kurrë kanga për ta s'nal,
Por k'to male dhe k'ta shkrepja,
Paskan rrit dhe sokolessha,
Gra malësore me xhubleta,
Fort punëtore, porsi bleja,
Me u pas hije punëtoria,
Me u krenue me to malësia,
K'to malësore sokolessha,
I kanë rrit trimat në djepa,
Tuj u knue kangë për trimni,
Tuj u thanë shumë histori,
Tuj u knue me za bilbilit,
Historitë e Dukagjinit,
Një burrnesh pat' rritë malësia,
Ja nigjoj zanin Shqipnia,
Si një trim që ban trimni,
Emën la në histori,
Zojë Mustafja ksaj i thonë,
Grua me famë për malsinë tonë,
N'histori për me i met kohës,
Kje e shpisë Pjetër Gjokës,

Lind në Theth, martue n'Gurr' t'Shoshit,
Me Mark Lulashin at' burr' motit,
Çift i mirë dhe i kompletum,
N'Dukagjin gjithkun t'nerum,
Zojë Mustafja kjo malësore,
Profesionin kish vajtare,
Gjithka i ra nëpër malësi,
Tuj vajtue djemtë e ri,
Tuj vajtue trimat e luftës,
Qe dhanë jetën para pushkës,
Tuj vajtue njerëz me nivel,
Që nga Shoshi deri në Shkrel,
Si kje natë apo kje ditë,
Vajto djallë e vajto çikë,
Vajto krenë e flamurtarë,
Trima lufte t'varun n'litar,
Si kangtari n'festivale,
Zani i saj piskamë ndër male,
Mej lillë fjalët për bukuri,
Me t'ba vajin poezi,
Kurr për fjalë ngusht mos me ra,
A thue n'leter t'shkrume i ka,
Komunizmi erdhi ndër male,
Vrau - burgosi njerëz me halle,
Shpejt po shkon atje n'malsi,
Me zhduk fe me mbledhë bagëti,
Por njaj flamurtari i Shoshit,
Burrë fisnik qebesa e zotit,
Kish nda mendjen me qindrule,
Komunizmin me lufteue,
Për fat t'keq një plumb i zi,
Marr e ka jetën e ti,
Zojë Mustafes fjalë i kan çue,
Flamurtarin me vajtue,
Nisë e ka vajin e ranë,
Asht drill Shoshi an' e mbanë,
Mallkon shtet e qeveri,
Gjithkush nie ban habi,
Kjo s'kish nollë ala n'malësi,
Por këtë gjamë ku pat vajtue,
Bukur shtrenjt e ka pague,
Lidh me pranga e kanë shtërngue,
Sikur burrë e kanë dënue,
Por s'ka burg që i mban' mrënë,
Kush lufton me pushkë e pendë,
Ata jashtë i nxjerr drejtësia,
Për ta shkruan historia,
Historia shkruan gjithmonë,
Për Zojë Mustafen e malsis' tonë.

Nikolin Guri
Korrik 2014

jo vetëm që janë gati të sulmojnë me të gjitha armët e mundshme objektin e tyre të urrejtjes por, pajtohen edhe me mundësinë e fljimit të vetvetes në luftë me armikun e tyre. I bëjnë hallall gjakun e derdhur dhe jetën e humbur, nga vetë ata dhe të afërmit e tyre. Frika dhe përfitimi vetiak nuk mund ta mposhtin më urrejtjen. Urrejtja kthehet në pushtet absolut mbi njeriun apo grupe kur ato mendojnë se nuk kanë asgjë për të humbur më, kur përfetojnë tunelin e errët dhe se, e vetmja rrugë e fitores është vdekja. Nëse të gjitha qëllimet kanë dështuar mbetet vetëm një, urrejtja. Dhe ky moment mendohet faza e nihilizmit, e shkatërrimit dhe rrënimit të plotë.

Urrejtja e pakufizuar, tek individi, grupi, religjionet dhe nacionet ka arsytet e veta të ekzistencës dhe zhvillimit. Niveli i ulët i civilizimit mendohet si njëri ndër

arsyet kryesore të urrejtjes pa kufi. Sipas H. Mann, përparimi i njeriut akoma nuk ka arritur deri tek mirëkuptimi me njerëzit dhe dyshimi. Dushan Radović shkon akoma më tej kur thotë: **Nëse do të ekzistojnë civilizime të zhvilluara në planetet e tjera, këtë të tonin me siguri ata do ta mendojnë ferr.**

E kundërta e civilizimit është barbaria. Filli ndarës midis tyre është shumë më i hollë se sa mund të mendohet. Vendi ynë për dy dekada postkomuniste përfetoi rikthimin e barbarisë i cili e asfiksoj atë civilizim të brishtë që kishim arritur. Në politikë, në administratë, në rrugë, në troje dhe kudo, i plotpushtetshëm u bë njeriu barbar. Pushteti i tij u bë i pakontrollueshëm. Kjo solli urrejtjen pakufi e cila u shoqërua me dhunën e pakontrolluar, deri në gjakderdhje. Kjo solli luftën civile të 1997, kjo solli rrënimin e Shqipërisë. Përmbysja e civilizimit

është njëri ndër elementët e karakterit të fshatarëve politikanë. Pikërisht kjo ndodhi tek ne në dy dekadat e fundit, postkomuniste. Shumë nga ata që ne i kishim menduar të civilizuar, u ribarbarizuan dhe ju bashkuan ushtrisë barbare duke u sjellur po aq barbarë sa dhe vetë barbarët. Pra, ndodhi fenomeni i ribarbarizimit të njeriut. Ribarbarizimi i njeriut është i njohur dhe i mundshëm. Është pabesia e hijes së prejardhjes e cila nuk heq dorë nga dhuna për tu rikthyer tek origjina, të paktën për zhvillimin e ndjenjës së urrejtjes deri në masën e kafshërisë, deri aq sa njeriu të vërtetojë vetë se është një bishë.

Urrejtja absolute, nga armë kundër objektit të urrejtjes, në të shumtën e rasteve, kthehet në armë vetëvrasëse për urryesin. Ndjenja e urrejtjes është njëra ndër ndjenjat e “egra” me fuqi shkatërruese të pallogaritshme për urryesin.

Njerëzit që vuajnë nga urrejtja absolute, pavarësisht nga kultura, shkollimi dhe civilizimi që kanë, ata ndodhen në pragun e ribarbarizimit, të kafshërimit. Urrejtja absolute ndaj të tjerëve, është vetëvrasje me porosi.

Urrejtja në përgjithësi dhe ajo absolute në veçanti lidhet ngushtë me fanatizmin dhe fundamentalizmin. Megjithatë fanatizëm nuk do të thotë direkt edhe urrejtje, ato gjithnjë qëndrojnë pranë njëra-tjetrës. *Fanatiku është tipi social i urrejtjes*, thotë filozofi gjerman G. Hole. Fanatik mendohet ai njeri i cili, gjatë gjithë jetës së tij, qëndron tek e njëjta ide e tij, të cilën ai e mendon më të mirën, më ideale. Mbrojtja dhe përhapja e idesë së tij, për atë, është më e rëndësishme se sa vetë jeta e tij. Ata që guxojnë të jenë skeptikë, indiferentë dhe të kundërshtojnë idenë e tij, ai i deklaron të rrezikshëm dhe si të

VASFI DUKA

NË PËRKUJTIM TË INXHINIERIT TË TALENTUAR, ZBULUESIN E MINERALEVE TË NGURTA, BIRIN E VRANISHTIT TË PËRMENDUR TË VLORËS, ANËTARIN E NDERIT TË SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI”

Këto ditë u nda nga jeta një nga intelektualët më në zë të Labërisë dhe Shqipërisë, inxhinieri i talentuar, zbuluesi i mineraleve të ngurta, biri i Vranishtit të përmendur, Vasfi Duka.

Autori i këtyre radhëve të vështira për tu formuluar, e ndjen jo vetëm për obligim personal të shkruaj dy fjalë për mikun dhe shokun që pati fatin të njihje në jetë e prej të cilit mësoi sa për një universitet të tërë, por edhe si një detyrim për shkrimet, intervistat dhe kontributin e tij intelektual dhenë shtypit të kohës dhe veçanërisht për ndihmën e sugjerimet që më jepte mua gazetarit jo profesionist për trajtimin në shtyp të problemeve koherente, falë kjo dhe eksperiencës së madhe që zotëronte në të gjitha fushat e jetës dhe veprimtarisë shoqërore.

Nuk ishte anëtar i asnjë partie politike, por jepte një kontribut të çmuar si intelektual i një kalibri të lartë për të gjithë ata që merreshin seriozisht me politikën, me ekonominë, me kulturën dhe gjithë fushat e zhvillimit të shoqërisë, duke ofruar e sugjeruar probleme pikante për trajtim e diskutim e duke i mbështetur ato me shifra, fakte e argumente që ai i zotëronte jo vetëm si specialist i profilizuar, por dhe si një nga intelektualët më të kompletuar të Armatës së madhe të intelektualëve që udhëhoqën ndërtimin e Socializmit, Epokën më të ndritur të popullit shqiptar.

Për të rikujtuar qytetarin dhe lexuesin e thjeshtë të këtij shkrimi modest, se kush ishte inxhinier Vasfi Duka, unë do të citoj jetëshkrimin e tij pasqyruar: - në “Kalendarin Enciklopedik Shqiptar” me autorë Aristidh Plaka e Ibrahim Xhamaj, botim i vitit 1998; - në Librin me titull “Veprimtaria individuale e specialistëve të fushave të gjeologjisë”, me autorë Akademik Profesor Teki Biçoku dhe Professore Marie Koçi, botim i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, viti 2004 si dhe - në Librin “Leksikoni i Lezhës” të autorit Kujtim Dashi, botim i vitit 2005, në të cilët shkruhet: “Inxhinieri gjeolog Vasfi Duka u lind në Vranisht të Vlorës më 1935. Pas mbarimit të Politeknikut 7 Nëntori, dega gjeologji – miniera, nga viti 1955 deri më 1958 punon si teknik gjeolog në Kurbnesh e Spaç të Mirditës. Vijon studimet në Institutin e Studi-

meve Gjeologjike “Orxonikidze” të Moskës në ish Bashkimin Sovjetik, vitin e fundit në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Gjeologji miniera. Në vitin 1965 emërohet Kryeinxhinier dhe pas tri vjetësh Drejtor i Ndërmarrjes Gjeologjike Rubik, ku udhëhoqi shërbimin gjeologjik në zbulimin e vendburimeve të bakrit në Kaçinar e Rrjollë, si dhe punimet për shtimin e rezervave të bakrit në Spaç



e Kurbnesh. Nga viti 1977 deri më 1986 si Kryegjeolog dhe më pas si Drejtor i Ndërmarrjes Gjeologjike të Shkodrës, udhëhoqi shërbimin gjeologjik, i cili bëri të mundur zbulimin e dorëzimin për shfrytëzim të minierës së bakrit në Palaj – Karmë, Shkodër (Për bakër të pasur); të vendburimit të Turecit në Lezhë (për përpunim); si dhe ju dorëzuan Komitetit Shtetëror vendburimi i Titanomagnetiteve të Kashnjetit, i Magneziteve të Gomsiqes, i Kaolinave të Vigut, i Argjileve të Melgushë – Bushatit, i Fluoriteve të Brashtës, i Silicorëve të Vilzës e të tjera, në Qarkun e Shkodrës. Në vitet 1986 deri më 1992 kur del në pension, punon i komanduar në Institutin e Studimeve Ekonomike në Tiranë, ku realizoi studime shkencore për mineralet jometalorë, për të cilat hartoi dhe “Klasifikimin Shkencor” të tyre, të parin inventar të këtij lloji në Shqipëri. Në të njëjtën kohë ai botoi me dhjetëra artikuj e studime shkencore për gjeoshkencën. Si special-

ist me përvojë e imagjinatë, përveç dëshirimit gjeologjik të Albanideve, ai ka meritë të veçantë në fushën e Gjeotrashëgimisë e të Gjeomjedisit, të cilat i studioi të lidhura ngushtë me trashëgiminë arkeologjike e kulturore të vendit. Në vitin 2004 pranohet Anëtar i Shoqatës Evropiane të Trashëgimisë Gjeologjike – “PROGEO”. Për shërbime të shquara në miniera e gjeologji ishte Dekoruar me Urdhrat e Klasit të Tretë, të Dytë dhe të Parë”.

Por nuk janë vetëm këto kontributet e Inxhinier Vasfi Dukës. Dy dekada jetë mbas daljes në pension ai nuk i kaloi si pensionist, por si një qytetar e intelektual aktiv. Moshën e tretë ai vijoi ta sfidojë me studime, me shkrime dhe me aktivitete praktike në interes të shoqërisë dhe vendit. Për asnjë çast Vasfi Duka nuk e pushoi punën studimore shkencore, por edhe pjesëmarrjen aktive në Shoqata Patriotike si ajo për Kosovën, në Shoqatën “Atdhetare-Dukagjini” ku ishte dhe Anëtar Nderi i saj, si dhe bashkëpunimin me shkrime me gazetatat e shoqatave të ndryshme të Labërisë, me të cilët kishte lidhje jo vetëm shpirtërore.

Në dy vitet e fundit të jetës, me nxitjen e shokëve që e adhuronin për dijet dhe eksperiencën që zotëronte, nisi të sistemonte materialet e tij shkencore për një botim të posaçëm. Por thjeshtë për arsye teknike, nuk arriti ta botonte. Megjithatë materiali në fjalë është në dorëshkrim i plotë dhe jam i sigurt se familja e tij e mrekullueshme dhe shokët që atij nuk i munguan brenda e jashtë vendit, do ta nxjerrin librin e tij në dritën e botimit, çka do të jetë një vlerë e madhe jo vetëm për specialistët e fushës së mineraleve, por për gjithë intelektualët dhe qytetarët e vendit. Se në librin e tij nuk janë thjeshtë zbulimet e inxhinier Dukës, por është “Nëntoka e gjallë e Shqipërisë dhe Kosovës” me xhevahiret e mrekullueshme që duhet t’i gëzojnë shqiptarët e jo të huajt.

Inxhinier Vasfi Duka, ndonëse ishte ndër zbuluesit më të përmendur në fushën e mineraleve; ndonëse pati një veprimtari e prodhimtari të madhe në fushën e studimeve shkencore dhe publicistike; ndonëse gjer në fund të jetës ishte pjesëmarrës aktiv

në tubimet shkencore në rreth, në shkallë vendi dhe në simpoziume evropiane, nuk arriti të merrte titullin e merituar “Profesor”. Vetëm me “Klasifikimin e mineraleve jometalorë”, që është një “Tabelë Mendelejevi për mineralet”, ai duhej të merrte titullin e mësipërm. Por kjo nuk ndodhi. Nuk ndodhi se Profesor Vasfi Duka, i zënë me punën e tij praktike e shkencore, nuk pati asnjëherë kohë të shkonte nëpër zyra ku hartohen “dokumentet” e marrjes së titujve shkencorë. Ai u mjaftua me rezultatet që pati nga puna; u kënaq me vlerësimet e shokëve që e njihnin nga afër; u krenua me evidentimin e kontributit dhe të jetës së tij në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar”, në median e shkruar para dhe pas vitit 1990, në Dokumentarin “Sfida e jetës” kushtuar jetës e punës së tij, prodhim i televizionit lokal të Shkodrës e gjer tek intervistat në Gazetën “JON” dhe televizionin “PASQYRA SHQIPTARE” e komunitetit shqiptar në Toronto të Kanadasë, ku vitet e fundit jetonte me djalin dhe vajzën e tij.

Inxhinier Vasfi Duka nuk arriti ta merrte titullin e lartë e të merituar të Profesorit, por mori respektin e jashtëzakonshëm të atyre që e njohën e punuan me të. Veçanërisht ai do të kujtonte gjithnjë me admirim dhuratën që mirditorët i dhanë si kujtim, kur ai u largua nga Mirdita: Një dhuratë simbolike, një valixhe të bukur mbushur me të gjithë kampionet e mineraleve të zbuluara prej tij në krahinën e Mirditës, të cilën inxhinieri e ruante me fanatizëm në një nga dhomat e shtëpisë në Shkodër, ku kishte bibliotekën e tij të pasur jo vetëm me libra shkencorë.

Mbi dy dekada punoi inxhinier Duka në Mirditë e në Shkodër. Labi nga Vranishti i Vlorës u miqësua kaq shumë me mirditorët dhe shkodranët, sa asnjëri prej tyre edhe pse ishte Kryeinxhinier e Drejtor Ndërmarrje, nuk i drejtohej me titullin e funksionit, por me përshëndetjen: “Tungjatjeta Vasfi Duka”. Dhe kjo vijoi edhe mbas daljes në pension.

Dhe përshëndetja “Tungjatjeta” i ka të gjitha vlerësimet, të ithë titujt që mund të fitojë një njëri në shoqëri. Ndaj dhe ne në këtë shkrim, nuk do t’i themi inxhinier Vasfi Dukës “Lamtumirë”, por do të përsërisim përshëndetjen e mirditorëve, dukagjinave e shkodranëve: “Tungjatjeta Vasfi Duka”. Sepse Vasfi Dukën e kemi e do ta kemi mes nesh. Se mes nesh kemi punën e tij, vlerat e tij, kontributin e tij të çmuar e të paharruar!

Përgatiti **GJON BRUÇI**

◀ tillë i mendon armiq. Mendimi i fanatikut kufizohet në dy pole: Me mua ose kundër meje. Ai që nuk është me mua, është kundër meje dhe duhet urreyer, luftuar dhe asgjësuar. Fanatiku nuk njuh kompromise. Tavolina e bisedimeve për atë nuk ekziston. Meqenëse i duhen forca dhe solidaritet në luftën kundër armikut të tij, fillon propagandën e urrejtjes. Kjo mushkësi quhet fundamentalizëm.

Fanatizmi, në përgjithësi, është dukuri e natyrës së njeriut injorant por, jo gjithmonë. Nga kjo sëmundje, njeri dhe shoqëri shkatërruese, nuk shpëtojnë as të shkolluarit dhe as ata që ne i mendojmë intelektualë dhe modern. Intelektualët, fanatikë të traditës dhe zakonet të vjetër, moralit, artit, politikës, besimit, patriotizmit, etj, për faktin se përmbajnë në vetvete një potencial të madh urrejtje kundër atyre që nuk janë si ata, mbe-

ten gjithnjë *rrëziku inteligjent dremitës*. Ata, edhe nëse pranojnë atë *ndryshe* për arsye të fuqisë madhore, nuk pajtohen kurrë me ato dhe me ata që nuk janë si ata. Ata urrejnë dhe urrejtjen e tyre mundohen ta shpërndajnë në çdo pikë ujë të mundshme që të mund ta pinë që tek foshnjat dhe deri tek më të vjetrit. Edhe nëse kjo sjellje mund tu kushtojë vendin e punës, shëndetin, madje edhe jetën. Njerëzit që urrejnë e vlerësojnë objektin e urrejtjes në mënyrë selektive. Pavarësisht se kush është ai dhe arritjet e tij, ai mbetet gjithmonë një njollë e zezë në psikikën e tyre. Për çdo rast ata e shikojnë dhe vlerësojnë atë në mënyrë të njëanshme, atë negative. Urryesit njohin vetëm intolerancën ndaj objektit të tyre të urrejtjes. Në marrëdhënie me objektin e tyre urryes, ata nisen nga parimi: Ju jeni ndryshe dhe ne nuk duam të bëhemi kurrën e kurrës si ju. Ndryshe

për ne do të thotë armik ndaj të cilit ne njohim vetëm një qëndrim: Urrejtje dhe luftë, deri në asgjësimin e tij. Që të mos bëhemi si ju, ne jemi gati edhe të vdesim në luftë kundër jush.

Njerëzit që urrejnë, mundohen vazhdimisht që ta poshtërojnë dhe dëmtojnë objektin e tyre të urrejtjes. Shkalla e poshtërimit dhe dëmtimit varet nga intensiteti i urrejtjes dhe pushteti që urryesi ka mbi objektin e urrejtjes. Në rastin e urrejtjes së butë dhe pushtetit relativ, urryesi mjaftohet me demonstrimin e epërsisë së tij mbi objektin e vet të urrejtjes. Nëse objekti urryes provon të kundërshtojë, atëherë urryesi shton intensitetin e urrejtjes dhe të pushtetit mbi të. Në rastin e urrejtjes mesatare dhe pushtetit të mjaftueshëm të urryesit mbi objektin e urrejtjes, urrejtja kalon në formën e dhunës. Urryesi nuk ka më si qëllim të vetëm sundimin e objektit të tij urryes

por, kalimin e tij në vuajtje. Ai do të shijojë kënaqësitë e vuajtjeve të tij, deri në sadizëm.

Në rastin e urrejtjes absolute dhe të pushtetit të pakufizuar, urryesi fillon fushatën e asgjësimit të objektit. Ky asgjësim mundet edhe të mos jetë fizik por vrasës i jetës sociale “vrasës shpirtërorë”. Puna është që urryesi ti japë të kuptojë objektit të tij se, jam unë ai që vendosi për jetën dhe vdekjen tënde. Dhe objekti ta kuptojë këtë. Njerëzit që nuk kanë pushtet ose aspak pushtet mbi ata që i urrejnë, kalojnë në fantazinë e urrejtjes ndaj tyre duke ju shpallur luftë me mend. Në fakt ata hyjnë në luftë me vetveten, një luftë kjo që, sa më e ashpër zhvillohet dhe sa më shumë që zgjatë, aq më e dëmshme dhe shkatërruese është për vetë personin. Kjo është, “vetëvrasje me porosi”.

**Nga libri “DHUNA”
i shkrimtarit Leke Imeraj**

LAJME

FESTOHET 4 KORRIKU NË "THE IMPERIAL HOUSE" - MIÇIGAN

I mbushur plot e përplot restoranti "The Imperial House", me pronarë Z. Ndue Ftoni, nga shqiptarë, të cilët ishin mbledhur për të festuar Shpalljen e Pavarësisë së Amerikës. Janë 238 vjet, që me 4 korrik 1776, trembëdhjete kolonitë e para Shpallen Pavarësinë e tyre nga kolonizatorët britanik. Populli amerikan e feston në mënyrë madhështore këtë festë. Janë shpenzime shumë të mëdha, vetëm nga fishekzjarrët që zbukurojnë qiellin amerikan për më shumë se dy tre ditë dhe arrijnë kulmin natën e 4 korrikut të çdo viti, janë shpenzime të pallogaritshme,

Si edhe herët e tjera, vitet e mëparshme shqiptaret, të cilët banojnë në shtetin e Miçiganit e kanë festuar Shpalljen e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara, diku të mbledhur nëpër institucione fetare, diku veç e veç, në formën e festivaleve të shoqëruara me muzikë vallëzimi dhe këngë nga këngëtarët e komunitetit shqiptar. Po ashtu dhe tregtarët ambulant kanë tregtuar në sheshet dhe oborret e këtyre institucioneve, pije freskuese, birre dhe ushqime të traditës shqiptare.

Këtë vit, restoranti, me pronar shqiptaro-amerikanin Ndue Ftoni, kishte menduar të zmadhonte përmasat e veprimtarisë, duke thirrë këngëtar me emër dhe që kanë sukses në skenat shqiptare këto vitet e fundit dhe që publiku artdashës shqiptar i ka duartrokur për paraqitjen e tyre.

Vëllezërit korçare, Andi dhe Stefi mbajtën gjalle për me shumë se 5 ore të pranishmit, të cilët ishin mbi 1000 shqiptar, që gëzonin, këndonin dhe vallëzonin për festën e Amerikës, që tashme është edhe e shqiptareve kudo që jetojnë e punojnë.

Kuzhina ishte e pasur dhe shqiptarët nuk u kursyen të shpenzojnë për pijet dhe ushqimet e mira dhe me shumice, të përgatitur për këtë festë.



AlbDream e ndoqi nga afër veprimtarinë dhe me këtë rast i mori dhe pronarit Ndue Ftoni një prononcim të shkurtër për të dhe për mundësitë që janë për të organizuar veprimtari të tilla në të ardhmen, me më shumë të ftuar nga jeta amerikane nga qytetaret e thjeshte amerikan për të festuar së bashku edhe në shenjë respekti dhe mirënjohje që shqiptaret kanë e duhet të kenë për shtetin dhe popullin amerikan, për ndihmën që kanë dhënë e japin për nacionalitetin shqiptar.

Ai, ne mes te tjerave theksoi: "Festa e Shpalljes së Pavarësisë së SHBA, data 4 korrik, që këtë vit daton me 238 vjetori e saj, është një feste jo vetëm për amerikanet, por për të gjithë emigrantet e çdo nacionaliteti në SHBA, por në veçanti për nacionalitetin shqiptar kudo ndodhur. Kjo, nuk është një diçka protokollare, por është themelore, ndihmën e së cilës e kemi pasur gjithmonë, por në veçanti në fillimet e Shpalljes së Pavarësisë së vendit tone, prej Presidentit Uilson dhe në vitin 1 999, për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb, prej Presidentit Clinton. Prandaj, kemi edhe një detyrim moral, dhe ju jemi mirënjohës në jete të jetës!

Me këtë rast popullit amerikan ju urojme gëzuar festën e Shpalljes së Pavarësisë, dhe pretojme se, në vitet në vijim do ta festojmë me një pjesëmarrje me përfshirëse, të gjithanshme, shqiptaro-amerikane ...".

Korespondenti i gazetës "Dukagjini" Miçigan RUSH DRAGU

PARAQITJA E LIBRIT "DHUNA", ME AUTOR LEKE IMERAJ

Me datën 29 qershor 2014, në mjediset e Universitetit "Marin Barleti", në Tiranë u zhvillua ceremonia e paraqitjes së librit me titull "Dhuna", të autorit Leke Imeraj, tashme skrimtar dhe përkthyes i njohur. Në këtë ceremoni morën pjesë shkrimtar, poet, jurist, pedagogë dhe të afërm e miq të autorit të li-



brit. Në mes tyre mori pjesë Mjeshtri Fadil Kraja e Ahmet Osja, poeti dhe kryetari i Klubit të Shkrimtareve dhe artisteve Shkoder, Skender Temali, e të tjere.

Ceremoninë e drejtoj gazetarja e mirejohur tashme në TV1-Chennai, Kozeta Bruçi.

Në këtë ceremoni dhane opinionet e tyre, redaktorja e librit, dr. Zamira Çavo, Mjeshtri Fadil Kraja, poeti Skender Temali, profesori doktor Lush Sustaj, vajza e autorit Valbona Imeraj, Kryetari i Shoqatës "Atdhetarë=Dukagjini" Ndue Sanaj dhe Naim Zoto, botuesi i librit.

Korespondenti i gazetës "Dukagjini"

PROTESTË KUNDËR NDARJES TERRITORIALE TË PARAQITUR NE QEVERIA



Me datën 26.07.2014 në vendin e quajtur "Harku i Bërdicës" u organizua një protestë paqësore kundër ndarjes territoriale që Qeveria ka vendosur të bëjnë. Merrnin pjesë disa dhjetra vetë nga Dukagjini, por edhe nga disa territore të tjera të rrethit të Shkodrës. Pjesëmarrësit për disa minuta bllokuan edhe rrugën automobilistike që lidh Shkodrën me Tiranën dhe Plazhin e Velipojës. Në këtë protestë përfaqësues nga protestuesit dukagjinës kërkuar edhe një herë që territoret e Dukagjinit të mbeten një bashki e veçnatë, gjë që është publikuar dhe paraqitur që prej disa kohe, por ka rënë në vesh të shurdhër të Qeverisë. Zoti P. Shkami i bëri me forcë thirrje Qeverisë që ta dëgjojë kërkesën e komunitetit dukagjinës me qëllim që të ruhet etnia, kultura, historia, të zhvillohet

turizmi, të mos shpopullohet krahina, të zhvillohet ajo dhe të ruhet të gjitha resurset pozitive të kësaj krahine të lashtë.

Korrespondenti i gazetës "DUKAGJINI"

"EJA FOTOGRAFO SHKODRËN DHE FITO", FITUES EMILIANO NËNSHATI

Konkursi i fotografisë "Eja fotofoto Shkodrën dhe fito" përfundoi duke shpallur fitues Emiliano Nënshati. Ky ishte aktiviteti i radhës në programin disaditor organizuar nga projekti "Marubi". Në këtë konkurs morën pjesë mbi 50 fotografë të rinj. Kjo iniciativë historiko-kulturore organizohet për herë të parë në qytetin e Shkodrës në kuadër të projektit "Marubi, një model bashkëpunimi për promovimin e turizmit ndërmjet Shkodrës dhe Ulqinit. Temat kanë qenë të lira dhe fotografët pjesëmarrës kanë pasur mundësi të fotofotojnë aspekte të ndryshme të qytetit të Shkodrës.

Pas përzgjedhjes së fotove më të mira, juria e këtij konkursi përcaktoi si fotoografinë fituese atë të shkrepur nga aparati fotografik i Emiliano Nënshatit, që nisur nga vetë mbiemri që ka të kujton menjëherë vazhdimësinë e traditës së të atit të tij, të fotografit të mirënjohur shkodran, Mjeshtrit Angjelin Nënshati, nder pasuesit më të denjë të Marubëve.

Fituesi Emiliano Nënshati u shpreh shumë i kënaqur për suksesin e arritur, duke theksuar se ka arritur të japë diçka nga shkolla e fotografisë së familjes Nënshati, ku pas ndarjes nga jeta të babait të tyre, ai së bashku me dy vëllezërit e tij, vazhdojnë traditën e familjes duke mbajtur në aktivitet të përditshëm studion "Nënshati", e cila jo rastësisht është e vendosur në krye të rrugës shëtitore "Idromeno" të qytetit të Shkodrës. Duke komentuar fotoografinë, me të cilën fitoi çmimin e parë, një portë e një shtëpie të vjetër shkodrane dhe prapa disa ndërtime shumëkatëshe, Nënshati tha se, ka pasur idenë që shtëpitë dhe oborret e vjetra shkodrane, po zëvendësohen me ndërtime të reja, që edhe pse kanë vlerat e tyre të zhvillimit të qytetit, duket sikur po zhdukin lagjet e vjetra të qytetit verior.

Korespondenti i gazetës "Dukagjini"



4 Korriku, 238 vjetori i Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës

4 KORRIK 2014, U MBUSHËN 238 VJET NGA DITA, QË KUR BURRAT MË TË NDRITUR TË KOMBIT AMERIKAN, NËNSHKRUAN DEKLARATËN E PAVARËSISË, DUKE U BETUAR, ASHTU SIÇ THUHET EDHE NË DEKLARATË, PËR NDERIN E TYRE, TË KOMBIT TË CILIT ATA I PËRKISIN

NEW YORK: 4 Korrikun Ditën e Pavarësisë-Datëlindjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe miratimin e Deklaratës së Pavarësisë më 4 korrik 1776, sot e nderon me pietete të mëdha çdo amerikan. Kjo është një ditë, e cila festohet në të gjithë Shtetet e Bashkuara me parada madhështore, parada patriotike, me ekskursione dhe piknikë familjare, e cila mbyllet me një natë të koncerteve dhe hedhjes në qiell të tonelatave të fishekzjarrëve, dhe është një arsye më shumë për të vendosur në çdo shtëpi flamurin amerikan.

“Amerika e bukur.” “Shtëpia e lirë dhe e të guximshmeve.” “Toka e mundësisë.” – “America the beautiful.” “Home of the free and the brave.” “The land of opportunity.”, këto janë frazat që ne do të dëgjojmë në mënyrë të pashmangshme në këtë 4 Korrik, që vjen si një kremtim solemn teksa Shtetet e Bashkuara po festojnë, sot përvjetorin e 238-të, kur u deklarua pavarësia e saj. Nuk ka asnjë dyshim që ky është një festim madhështor patriotik i çdo amerikani.

Dita e Pavarësisë është dita kombëtare e Shteteve të Bashkuara:

Çdo vit, më 4 korrik (si sot e premtë 4 Korrik 2014), amerikanët festojnë së bashku me familjet e tyre, lirinë dhe pavarësinë me piknikë, dhe tubime familjare. Autoritetet, shtetërore dhe federale kanë mobilizuar mijëra oficerë të policisë, për të patrulluar rrugët dhe sheshet e qendrave të banuara. Forca të tjerë të ruajtjes së rendit do të ruajnë hotelet dhe pikat tërheqëse për turistët, sidomos kjo në qytet më të mëdha përfshirë Nju Jorkun.

Miliona njerëz si për shembull në Neë York, dhe në disa shtete të SHBA do të jenë në gjendje të gëzojnë sonte spektaklin e mahnitshëm me fishekzjarrë, i cili është mbresëlënës dhe është një natë e shumë prituri. Veprimtarte lidhur me ditën e pavarësisë përfshijnë dhe garat dhe ngjarjet sportive, e koncerte në skena të hapura me këngëtarë nga më të njohurit në SHBA.

Deklarata e Pavarësisë është një dokument nëpërmjet të cilit 13 kolonit e Mbretërisë së Bashkuar nga Amerika e Veriut shpallën veten të pavarur nga Mbretëria e Bashkuar. Dokumenti u ratifikua nga Kongresi Kontinental më 4 korrik 1776. Deklarata e Pavarësisë është një nga simbolet e lirisë, dhe më të dashura e të nderuara të Shteteve të Bashkuara.

238-vjetori i Ditës së pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose Datëlindja e Amerikës! Kjo është dita kur lindi Deklarata e Pavarësisë dhe Kushtetuta amerikane, është ditë gëzimi, jo vetëm e amerikanëve, por edhe e nacionalitetit shqiptar.

Sot, më 4 Korrik 2014, u mbushën 238 vjet nga dita, që kur burrat më të ndritur të kombit amerikan, nënshkruan

Deklaratën e Pavarësisë, duke u betuar, ashtu siç thuhet edhe në deklaratë, për nderin e tyre, të kombit të cilit ata i përkisnin.

Kushtetuta amerikane, e nënshkruar në vitin 1787, dhe përshkruan bazën dhe strukturën e qeverisë të Shteteve të Bashkuara, e cila është e ndarë në tri

cia, liria e popujve, të mbrohet atje ku ajo dhunohet dhe shtypet. Armiqtë më të mëdhenj të Amerikës, nuk janë popujt, por janë diktaturat e diktatorët, shtypja e popujve liridashës, skamja dhe mjerimi i tyre.

Miku më i Madh i Amerikës, është ai nacionalitet që do dhe lufton për paqen,



degë, në ato ekzekutive, legjislativë dhe juridike, që në një gjuhë më të thjeshtë janë Presidenti, Kongresi dhe Gjykata e Lartë.

Kur gjatë luftës për çlirimin e Kosovës shtrohej pyetja pse amerikanët duhet të vdesin për Kosovën, natyrshëm dilte përgjigjja e këtij nacionaliteti të madh: se burrat më të ndritur të këtij kombi, më 4 korrik, si sot, 238 vjet më parë, kishin vendosur të krijojnë shtetin e bazuar në lirinë dhe të drejtat e barabarta të secilit nacionalitet.

Trashëgimia dhe porositja e tyre e çoi Amerikën në luftë, për të mbrojtur principet e lirisë dhe demokracisë amerikane edhe në Kosovë, dhe të gjitha ato vende të shtypura nga diktaturat. Për Amerikën gjëja më e shenjtë, e cila simbolizon edhe këtë datë, është fjala liri e demokraci. Pra, liria e Kosovës dhe e shqiptarëve në vite ishte emër kuptimplotë për Amerikën dhe nacionalitetin shqiptar.

4 Korriku kumbon thellë në zemër tek tri fjalët e para të Kushtetutës amerikane, “we the people”, “ne populli”, për të theksuar rolin e rëndësishëm që shtetasit amerikanë kanë në qeverinë e Shteteve të Bashkuara:

Ato tre fjalë u bëjnë thirrje amerikanëve të mos harrojnë se përveç pushtetit që ata ushtrojnë ndaj qeverisë, nëpërmjet të drejtës së tyre të votës, ata duhet të mbajnë edhe përgjegjësinë për lirinë e vendit të tyre.

Besojmë se askush më mirë se ne shqiptarët, nuk e ka kuptuar këtë, askush më mirë se ne shqiptarët nuk e di faktin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë betuar në nderin e tyre dhe që demokra-

lininë dhe demokracinë, jemi ne shqiptarët.

4 Korriku, Data e pavarësisë amerikane, aq sa i përket sot nacionalitetit amerikan, po aq na përket edhe shqiptarëve, nacionalitetit shqiptar. Nacionaliteti shqiptar feston 4 Korrikun, ashtu siç feston 28 Nëntorin e Pavarësisë së shteti shqiptarë, ashtu si feston çlirimin dhe lirinë e pavarësinë e Kosovës, 12 qershorin 1999, e cila i është mirënjohëse për jetë Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Presidenti i parë historik i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, ia ka dedikuar sa ishte gjallë, gjithë këtë mrekulli admirimit dhe respektit që kanë shqiptarët për Amerikën, presidentëve Uilson, Regan, Klintonit, që i tha ndal gjenocidit në Kosovë me intervenimin ushtarak, sulmet ajrore të NATO-s, por edhe me të ashtuquajturën “Vija e Kuqe” në prag të Krishtlindjeve të Bushit të vjetër, por edhe presidentit George E. Bush, i cili i vizitoi për herë të parë trupat amerikane në Kosovë, fill pas inaugurimit presidencial, dhe në vizitën e parë të një presidenti amerikan në detyrë kur vizitoi Tiranën dhe deklaroi “Kosova vetëm e pavarur nga Serbia dhe mjaft është mjaft”.

Presidenti i i ndjerë i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, patë thënë se: “Ne shqiptarët i duam amerikanët sepse ata na dhuruan lirinë, që ne dëshironim – pikërisht për këtë ka një respekt ideal. Me Amerikën ne jemi të vegjël, por miq të mëdhenj që mund të bëjmë edhe punë të mëdha”.

Ndërkohë, sot më 4 Korrik 2014, kur Shtetet e Bashkuara po kremtojnë 238 vjetorin e Pavarësisë së saj nacionaliteti

shqiptar dëshiron të tregojë me singheritetin e tij se shqiptarët, u janë mirënjohës miqve të tyre të shumtë amerikanë, ndër të cilët presidentit Eoodro E. Eilson, për përpjekjet që kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë për nacionalitetin tonë dhe për ruajtjen e miqësisë shqiptaro-amrikane, e cila këtë vit shënon 92 vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike.

Dhe kjo është në traditën amerikane, me politikën që ka mbajtur gjithnjë kundrejt Shqipërisë, të filluar prej presidentit të madh, Eoodro E. Eilson, kujtimi i të cilit ka mbetur i paharruar në zemrat e mendjet e shqiptarëve.

Në Konferencën e Paqes, në Paris, në fund të Luftës së Parë Botërore, Presidenti Woodro E. Wilson, flaku poshtë Traktatin e Fshehtë të Londrës (1915), që sakrifikonte të drejtat legjitime të Shqipërisë dhe u kërkoi përfaqësuesve të fuqive të mëdha, respektimin e pavarësisë së plotë të Shqipërisë, duke deklaruar se “Kufij e botës nuk ndahen sipas madhësisë, por sipas nacionaliteteve që atyre u përkasin”.

Mirëpo, duhet theksuar se, megjithëse regjimi komunist i Enver Hoxhës, për 50 vet i ndërpreu lidhjet me SHBA, tek zemrat e shqiptarëve në vite u rrit e u farkëtua miqësia shqiptaro-amrikane. Me këtë rast shqiptarët nuk e harrojnë presidentin Bush (plakun), në prag të Krishtlindjeve, i cili vendosi “vijën e kuqe”, vijë që sinjalizoi diktatorin Millosheviq, që kurrë Amerika s’do të lejonte një Bosnje të dytë, me shqiptarët. Vizitën në Shqipëri të Sekretarit të Shtetit James Bake, në vitin 1991. Vizita, që beri në Shqipëri, në qershor 2007, Presidenti i 43-te, SHBA-se, George E. Bush, padyshim që mbetet një nga vizitat me te rëndësishme, që ka bere ndonjëherë një personalitet i larte i politikës botërore, gjate gjithë historisë së këtij vendi të vogël të Ballkanit, me tre besime fetare, që jetojnë në një bashkëjetesë dhe harmoni shembullore fetare.

Edhe presidenti Bill Clinton, u qëndroi besnik fjalëve të paraardhësit të tij, presidentit George H. Bush. Clintoni, u bë njeriu më i dashur dhe më i besuar për shqiptarët kur premtoi: “Amerika do të jetë me Kosovën!”

Amerika ishte me Kosovën në luftë, tani ajo është me Kosovën në paqe, me Kosovën në liri, me Kosovën në Pavarësinë e saj. Amerika ishte garant i ngadhënjimit të luftës ndaj diktaturës së egër të Millosheviçit dhe tani ajo është garant që Kosova të ndërtojë në paqe shtetin demokratik të Kosovës, pavarësinë e saj shtetin demokratik, sovran dhe të pavarur.

Përgatitë nga **BEQIR SINA**
New York

Faqja letrare

RAPSODËT E LAVDISE

Kush i këndoi burrat e lavdisë
Trimave të pushkës, besës e burrnisë
E ruejtën vlerat e historisë
Në këto malet e malësisë
Lartësoi trimat e vatanit
Ishte kanga e lahutarit
Këtu lahuta e çiftelia
Rritë bashkë ku ishte burrnia
Bashkë jetuen dhe luftuen
Vlerat vendit ja naltësuen
Me i kujtue lahutarët e motit
Mirash Ndou në Palaj t’Shoshit
Zani i tij plot bukuri
Lahutar me shumë aftësi
Rrespekt gëzoi në gjithë malësi
Kur këndontë ai Gjergj Marku
Merr kënaqësi, t’shtohet maraku
Kënga e tij ishte jehonë
Me vëlla Kolën po këndojnë
Zemra u kënoftë për gjithmonë
Po një lahutar me za piskamë
Asht Gjergj Pellumbi trim i rrallë
Pushke e lahutë kurrë si ka nda
Tri herë për vdekje e kanë denue
Por desht Zoti, ka mbijetue
Gjithmonë Thethi ka me kujtue
50 vjet lahutën kurdisi
Kangët e moçme në dritë i qiti
Ai qendroi në ballë t’burrnisë
U këndoi Agëve të Jutbinës
Trimërive të Halilit e të Mujit
Sokol Martini në Brisë t’Mërturit
Kur qe shpallë Pavarësia
Me lahutë në dorë u nis nga shtëpia

E në Vlorë me shkue në kambë
Me përshendetë atje me kangë
Kujt i dha madhështi sharkia
Në Curraj Epërm Zef Avdia
Kanga e bukur e bani t’njoftun
Nëpër skena, podjume e trevese
Trashigim marrë në votër
Atje n’Btoshë ai Gëzim Nika
Shpirti i tij asht veç muzika
Ku tingëllon epika e lirika
Atë za t’thekshëm plot freski
U ba i njoftun në gjithë Shqipni
Kujt i lindi kanga n’zemër
Në male tona bani emën
Në folklore vend nderi zuni
Asht rapsodi Mëhill Çuni
Krijimtar dhe bukur këndoi
Shumë folklorin e pasuroi
Një rapsod tjetër emën bani
Asht prej Shoshi Gjovalin Shani
Si bylbyl këndon përditë
Me kangë t’bukura e meloditë
Kangët e moçme s’po i harron
Mirë ngjarjet i rreshton
Po ruen vlera e traditë
Krijimtaria po i shndrit
Me aftësi shkruen historitë
Kush jehone muer në skena
Bylbyli i Nikajve Syk Papleka
Atij kanga i dha madhështi
Baba Mark me shumë aftësi
I mësoi lahutë dhe sharki
Ju ndërpre jeta në rini
E pat lanë nje amanet
Asaj Gofiles motrës vet

Pash at Zot motër që t’ka falë
Kangën kurrë mos me ndalë
Shkëlqejne dy yje porsi ari
Janë Fran Kodra e Ndue Shytani
Krijues t’fortë dhe kangetarë
Në krye t’folklorit flamurtar
I kanë dhanë malësisë lavdi
Me kangë t’bukura plot freski
Shumë rapsod na solli jeta
Atje n’Palç ai Zef Beka
Me kangë lirike e rapsodi
Ka fitue shumë aftësi
Shumë rapsod malësia rriti
Me folklor të dalë nga shpirti
Kanga e tyne vlera qiti
Të gjithë ngjarjet i shendriti
Ato ishin gëzimi e trishtimi
Dhe në luftë kanga prini
U rrit forca e guximi
Motet ikin, të tjera vinë
Ngjarjet ruejne përjetësinë
Brezi i ri do ruej lavdinë.
PIJETËR GERAJ,
Shkodër, qershor 2014

PËR VETE DHE PËR JU...?
Kur njerëzimin e mbërtheu kriza
dhe tokën e kërcënoj
ngrohja globale..
unë ngarkova një çante
me ëndrra dhe kujtime
e u ngjita... lart në male...

Derën e kullës e gjeta pa dry..
ajo u hap vetë..
nuk pata nevojë me e shty.
Në oxhak një cung i madh
gjysma dru e gjysma hi ...?
Folën muret me mua,,,
apo fola unë me vete: Se di...!

Cep në cep fshatit i rashe
e zog as rob nuk pashe...?
Veç zhurma e kroit që ishte mbulua me ferra...
dhe krisma e dardhave...
që i rrëzonte era...?

U ngjita larte në bjeshke...
tek mrizi i madh shekullore...
Eh... u kënaqa...

Mu duk se... u rrita një pëllëmbë
Mu duk se qiellin e preka me dore...!

Shkova tek një gështenje së bashku
që dikur me kapuç e kanë nda...?
fjeta në një konak të vjetër
se isha lodh, e nata ra...

Nuk e di se kur fjeta,
nuk e di as kur jam çua
Por e di se...?
... nuk kam lanë gjë pa thanë.
Për vete, dhe për ju...?

KONKURENCA...
Jeta është luftë e vërtetë
në çdo fushë ka konkurrencë
E vërteta rralle fiton
veç kur ka shumë eksperiencë...
Të gjithë e duan pasurinë
por dikush nuk ja di vlerën...
kur e ke Zotin me vete
kudo te shkosh ta hapin derën..

Jeta është një gare e ashpër
konkurrence kudo që shkon...
të rren syri... të rren ligji...
vetëm zemra të dëfton...
Një kolltuk e një karrige...
e kërkojnë me qindra vete...
e shijon dhe e arrin...
veç kush ka xhepin e nxehtë...?

Me mashtrime dhe me hile

ka shumë njerëz që po fitojnë...
disa shuhen si flakë kashte
disa kurrë nuk i gëzojnë
Jo çdo gjë që kushton shumë
është e bukur dhe e çmuar...
Veç ajo që ta ngroh zemrën
ka një vlerë të papaguar...

TANI E DI...?
Kur ëndrrat mi vranë
njoha zhgënjimin...
dhe desha t’ju them; faleminderit...?
atyre që më urrejnë
sepse u bëra më i forte...

Kur miqtë më morën anën...
njoha tradhtinë
dhe desha t’ju them ; faleminderit...?
atyre që më kane zili
më bëtë ndihem i veçante ...

Kur isha në rrugë të ngushtë
njoha miqtë
dhe desha t’i falënderoj..
sepse më ju ndihem i rëndësishëm.

Kur e ndalova vrapin
vetëm për një çast...
U binda se ky është realiteti
Kur dhurova dashuri

U ndjeva i lumtur...
dhe desha t’ju them se nuk jam penduar...
por nëse ndonjë ditë
më duhet të bëj bilancin
tani e di mjaft mire se
ku e ka vendin secili nga ju...?

ME VJEN TË BERTAS...!
Kam filluar të flas me vete
kur shoh se si...
nata përqesh terrin e ditës..!
e dita lakmon dritën e natës
Se di...?

Se di, por kur shoh se tradhtia
flet nga tempulli i dashurisë
e dashuria bredh rrugëve të harresës.
Më vjen të bërtas!
por vetëm flas me vete!

Kur shoh se jeta shoqërohet
pa aspak mëdyshje me vdekjen,
e vdekja nuk dëshiron
të kthehet në ketë jete...?

Mërzitem më të vërtetë...
dhe them me vete;

O Zot i madh:
Si u lëmsh këtë botë ??
ku gjërat normale...
duken si çudi...
mashtrimi ecën rrugëve ...
ndërsa e vërteta fluturon mbi re...
Ah... ekstremet puthen...
dhe përqafohen çdo dite me ne...!

E shoh këtë realitet...
mendohem dhe vuaj...
Më vjen të bërtas...!
...por vetëm ulëm dhe shkruaj!
LULASH BRIGJA 2014

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Lazër Stani, Roza
Pjetri, Prelë Milani, Luigj
Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika,
Zef Gjeta, Lulash Brigja

